



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Raporti i Vetë-vlerësimit

2014-2015

Ky raport mbulon periudhën nga **1 shtatori 2014** deri **31 gusht 2015**

Table of Contents

1.	Hyrje	4
2.	Të arriturat.....	5
3.	Struktura: fakultetet dhe qendrat	6
3.1.	Fakulteti i biznesit dhe ekonomisë	7
3.2.	Fakulteti i shkencave dhe teknologjive bashkëkohore	8
3.3.	Fakulteti i gjuhëve, kulturave dhe komunikimit.....	8
3.4.	Fakulteti i drejtësisë	9
3.5.	Fakulteti i administrimit publik dhe shkencave politike.....	10
3.6.	Qendra e gjuhëve	10
3.7.	Qendra eLearning.....	11
4.	Sigurimi i cilësisë	11
5.	Mësimdhënia dhe të mësuarit	14
5.1.	Programet dhe statusi.....	14
5.2.	Regjistrimi i studentëve.....	14
5.3.	Kalueshmëria e studentëve.....	15
5.4.	Diplomimi i studentëve	16
5.5.	Qendra e karrierës dhe punësueshmëria.....	17
5.6.	Asociacioni Alumni	18
6.	Hulumtimi	18
6.1.	Instituti hulumtues “Max Van der Stoel”	19
6.2.	Instituti i mjedisit jetësor dhe shëndetit	20
6.3.	Zyra për marrëdhënie ndërkombëtare	21
7.	Ndërmarrësia dhe zhvillimi.....	21
8.	Financimi	23
9.	Mjedisi dhe shërbimet në kampus	24
9.1.	Përkrahja studentore	24
9.2.	Ngrehinat dhe kapacitetet teknike.....	25
9.3.	Qendra e UEJL-së në Shkup.....	26
9.4.	Burimet njerëzore	27
9.5.	Sistemet e informacionit	28
9.6.	Shërbimet e bibliotekës	29
9.7.	Parlamenti i studentëve	29
9.8.	Sporti dhe rekreacioni.....	30
10.	Konkluzionet.....	31

1. Hyrje

Ky raport përfshin periudhën kohore nga 1 shtatori 2014 deri në 31 gusht 2015. Gjatë kësaj periudhe, Universiteti ka shënuar përvjetorin e trembëdhjetë.

Universiteti vazhdon të funksionojë me pesë fakultete në dy kampuset. Kampusi origjinal i Universitetit në Tetovë ofron një ambient të stilit akademik perëndimor dhe kampusi i ri në kryeqytetin e Shkupit shtrihet përgjatë urës që lidh pjesën e vjetër dhe të re të qytetit. Pesë fakultetet përbërëse të Universitetit janë: Fakulteti i Biznesit & Ekonomisë; Fakulteti i shkencave dhe teknologjive bashkëkohore; Fakulteti i gjuhëve, kulturave dhe komunikimit; Fakulteti i drejtësisë; dhe Fakulteti i administratës publike dhe i shkencave politike. Që të pesë fakultetet ofrojnë programe në të tri ciklet e studimit të arsimit të lartë (gjegjësisht, deridiplomike, pasdiplomike, dhe studimet e doktoratës). Shkolla e doktoratës vazhdon të tërheqë studentë premtues nga Maqedonia dhe rajoni.

Ashtu si edhe institucionet tjera të arsimit të lartë në mbarë botën, UEJL vazhdon të përballet me vështirësitë e paraqitura nga gjendja e rëndë e vazhdueshme e ekonomisë globale. Për institucionin tonë, këto probleme janë zbutur disi nga vendimi i Qeverisë së Maqedonisë - i cili implementohet në periudhën e këtij raporti, për të siguruar mbështetje financiare për UEJL në vlerë prej 500.000 euro. Kjo shumë mundësoi që Universiteti të bëjë ofertën më bujare për bursa që ka bërë ndonjëherë më parë, që lidhen me suksesin e dëshmuar në arsimin e mesëm. Megjithatë, duhet pranuar se vështirësitë e vazhdueshme financiare me të cilat ballafaqohen shumë familje në vend kanë tendencë për të zvogëluar regjistrimin në institucionet ku paguhen tarifa për shkollim si në UEJL. Gjithashtu mbetet e vërtetë se nataliteti në rënie dhe emigrimi në rritje kanë reduktuar numrin e regjistrimeve dhe kështu e bëjnë shumë më konkurrues regjistrimin e studentëve. Së fundmi, nivelet e përgjithshme të investimeve në hulumtim dhe arsimim mbeten të ulëta në të gjithë rajonin e Ballkanit, të paktën në krahasim me Bashkimin Evropian dhe standardet e Amerikës së Veriut.

Universiteti i Evropës Juglindore megjithatë mbetet një institucion i qëndrueshëm dhe tërheqës i arsimit të lartë, siç dëshmohet nga regjistrimi i qëndrueshëm në të tri ciklet akademike. Stafi administrativ dhe stafi i mirëmbajtjes dhe kapaciteteve teknike ofrojnë mbështetje të shkëlqyeshme për institucionin dhe studentët. Stafi akademik ofron mësimdhënie solide, të mbështetur nga një infrastrukturë e mirë dhe moderne, e udhëhequr nga mekanizmat ndihmëse për sigurimin e cilësisë (të tilla si sesione trajnimi, anketat me studentët, vëzhgimi i mësimdhënies nga kolegët). Nga stafi akademik pritet që të jenë mësimdhënës dhe hulumtues aktivë dhe kjo është reflektuar në portofolet e tyre mësimore, planet individuale të hulumtimit, qasje në fondet financiare për mbështetje të hulumtimit si dhe proceset për promovim në thirrje kërkojnë përsosmëri në mësimdhënie dhe hulumtim. Kjo është një shenjë e suksesit të institucionit ku shumë të diplomuar në UEJL aplikojnë për t'u kthyer tek ne për ciklin e tyre të ardhshëm të studimeve.

Universiteti vazhdon të jetë i veçantë në nivel rajonal në angazhimet dhe misionin e tij. UEJL mbetet institucioni i vetëm i arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë për ku aplikohet politika e 'përdorimit fleksibil të gjuhëve, ku çdo student ose anëtar i stafit mund të komunikojnë në njërin prej tri gjuhëve zyrtare në nivel të Universitetit—shqip, maqedonisht dhe anglisht. Mësimdhënia mbahet në të trija prej këtyre gjuhëve nëpër fusha të gjera të specializimit dhe gjuhë të tjera të caktuara (gjermanisht, frëngjisht, italisht) janë në dispozicion për interesin e studentëve, si lëndë

'zgjedhore të lira'. Universiteti gjithashtu mban një politikë të rreptë të mosdiskriminimit, duke e mos bërë dallime në mesin e stafit ose studentëve në bazë të gjuhës, përkatësisë etnike, gjinisë, fesë, apo sociale. Universiteti mbetet një institucion i rëndësishëm rajonal jo vetëm për shkak të asaj që studentët studiojnë, por për shkak të dëshmive që ofron për përpjekje bashkëpunuese të të gjitha grupeve sociale, gjuhësore e etnike.

Universiteti vazhdon përpjekjet drejt kontributit pozitiv institucional dhe e ofron sigurimin e shembullit të mirë. Prandaj, ky institucion ka ruajtur angazhimin e vet të dukshëm ndaj përgjegjësisë mjedisore me lëshimin në përdorim të sistemit të ngrohjes me biomasë (peletë), impiantin fotovoltaik dhe nënshkrimin e Memorandumit për bashkëpunim me komunën e Tetovës për mbrojtjen e mjedisit. Universiteti gjithashtu hapi një pikë karrikimi në Shkup për makinat elektrike.

Universiteti gjithashtu është krenar që ofron mbështetje të fuqishme për studentët dhe stafin. Qendra e Karrierës ofron ndihmë praktike për të gjithë studentët, ofron trajnime dhe këshilla për teknikat e kërkimit të punës dhe organizon Panairin e karrierës në Universitet në pranverë. Qendra e gjuhëve ofron trajnime të gjuhës për të gjithë studentët, në mbështetje të angazhimit të Universitetit për shumëgjuhësi, ndërkombëtarizim dhe “përdorimin fleksibil të gjuhëve”. Qendra eLearning ofron trajnim në përdorimin e teknologjive kompjuterike dhe për përmirësimin e shkathtësive teknike. Të gjithë anëtarët e stafit i nënshtrohen procesit të vlerësimit vjetor të stafit që përfshin bisedë të drejtpërdrejtë dhe raportim të marrëveshjes me menaxher drejtpërdrejtë të linjës. Në të gjitha këto fusha, UEJL vazhdon të ndjekë politikat dhe procedurat që promovojnë cilësi, përgjegjësi dhe mundësi për studentët dhe stafin.

Vitet e fundit kanë qenë të vështira për shumë institucione akademike dhe UEJL nuk ka qenë imune ndaj sfidave me të cilat përballen ofruesit e arsimit të lartë. Një plogështi e vazhdueshme financiare në rajon redukton fondet për të gjitha institucionet, si dhe rënia e lindjeve dhe emigrimi e bëjnë rekrutimin e studentëve gjithnjë e më konkurrues. Megjithatë, Universiteti i Evropës Juglindore vazhdon të ofrojë arsim të cilësisë së lartë, në tri gjuhë, dhe pa dallim apo preferenca mes gjuhës, përkatësisë etnike, gjinisë, apo fesë.

2. Të arriturat

Gjatë vitit akademik 2014-2015, kontributi i Universitetit në arsimim dhe hulumtim në vend janë njohur nga Qeveria e Maqedonisë, e cila ka dhënë gjysmë milion euro në mbështetje të financave të Universitetit. Kjo mbështetje bujare mundësoi që Universiteti të strukturojë dhe të ofrojë bursa për studentët që regjistrohen në vitin akademik 2015-2016. Këto bursa janë përshtatur sipas suksesit të dëshmuar akademik në arsimin e mesëm, me shumatat e shkallëzuara në varësi të notës mesatare të arritur nga aplikantët në arsimimin e tyre të mesëm.

Universiteti vazhdon të ketë rol të fortë në kuadër të komunitetit ndërkombëtar të Maqedonisë. Në mënyrë të veçantë, ne kemi qenë të nderuar nga vizitat e mysafirëve të shumtë nga e gjithë bota, veçanërisht nga anëtarët e komunitetit të akredituar diplomatik ndërkombëtar në Maqedoni (të tilla si ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar, ambasadori i Gjermanisë, Ambasadori i Polonisë, Shefi i Misionit të OSBE-së, dhe të dy ambasadorët Shteteve të Bashkuara të Amerikës ai në ikje dhe ai në ardhje). Në mënyrë të ngjashme, anëtarët e delegacioneve të huaja kanë realizuar vizita të shumta në Universitetin e Evropës Juglindore, përfshirë edhe një delegacion diplomatik të shteteve të

Beneluksit, një delegacion parlamentar nga Shqipëria, zëvendëskryeministri (dhe ministri i jashtëm) i Kosovës, dhe ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Kosovës. Njëlloj të mirëpritur në Universitet ishin përfaqësues të Qeverisë dhe komunave të Maqedonisë, duke përfshirë periudhën e mbuluar nga ky raport, Universitetin e kanë vizituar Kryeministri i Maqedonisë, ministri i Arsimit dhe Shkencës së Maqedonisë, Ministri i Drejtësisë së Maqedonisë, dhe kryetarja e Komunës së Tetovës.

UEJL gjithashtu kishte kënaqësinë të presë akademike të shquar në një shumëllojshmëri të konferencave dhe funksioneve. Universiteti ka përfituar nga tri rishikimet e jashtme të fakulteteve të realizuara nga profesorët nga Kroacia dhe Shtetet e Bashkuara. Disa ligjërues ndërkombëtarë gjithashtu kanë mbajtur ligjërata individuale apo modulare në kampuset tona. Ka pasur edhe konferenca të shumta dhe diskutime – tryeza të rrumbullakëta gjatë periudhës së mbuluar nga ky raport. Universiteti organizoi dhe ishte nikoqir i konferencës në përkujtim të 800 vjetorit të Magna Carta-ës, duke tërhequr panelistë nga Maqedonia, Mbretëria e Bashkuar, dhe Shtetet e Bashkuara. Gjithashtu e dallueshme ishte konferenca e organizuar nga Instituti Hulumtues Max van der Stoep i UEJL-së dhe Institutit Demokratik Kombëtar (National Democratic Institute), dhe e mbështetur nga Ambasada e Polonisë, me titull "Roli i shoqërisë civile në transformimin politikë dhe shoqërore, Perspektivat nga Polonia dhe Maqedonia".

Universiteti vazhdoi pjesëmarrjen e tij në Projektin NORMAK për energji të qëndrueshme. Ky projekt, që është financuar nga Ministria Norvegjeze e Punëve të Jashtme, sjell bashkëpunim në fushën e energjisë së qëndrueshme në mes Universitetit të Evropës Juglindore, Universitetit të Prishtinës dhe Universitetit Politeknik të Tiranës.

Gjatë periudhës së këtij raporti, UEJL gjithashtu filloi një projekt të rëndësishëm bashkëpunues të bashkëfinancuar nga USAID dhe Fondacioni Ndërkombëtar Lions Club. Ky projekt, i titulluar Fëmijët me aftësi të kufizuara pamore, synon ta rrisë pjesëmarrjen e studentëve të verbër ose me shikim të dëmtuar në Maqedoni dhe do të fokusohet veçanërisht në aplikimet e teknologjisë për t'i ndihmuar nxënësit e verbër apo pjesërisht me shikim të dëmtuar (si, për shembull, duke siguruar teknologji të reja dhe trajnime për të krijuar materiale në alfabetin Braille). Kjo përpjekje do t'i lidhë partnerët në mes UEJL me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës së Maqedonisë dhe Shoqatën e të verbërve në Maqedoni. Projekti, që do të realizohet gjatë një periudhe prej tridhjetë muajve, do të financohet nga një grant prej pesëqind mijë dollarësh amerikanë.

Universiteti pa një rënie të lehtë të numrit të aplikantëve dhe studentëve të regjistruar në vitin akademik 2014-2015, në krahasim me vitin akademik 2013-2014. Gjatë përgatitjes së këtij raporti u vu re se aplikimet për vitin akademik 2015-2016 janë tashmë më të larta se ato të vitit akademik 2014-2015.

Universiteti festoi përvjetorin e tij të trembëdhjetë dhe në ceremoninë festive dha titullin *honoris causa* sipërmarrësit vendas Nazif Dastani.

3. Struktura: fakultetet dhe qendrat

Universiteti i Evropës Juglindore operon me dy kampuse universitare në Tetovë dhe në Shkup. Struktura e universitetit përbëhet nga pesë fakultetet:

- ❖ Fakulteti i biznesit dhe ekonomisë;

- ❖ Fakulteti i shkencave dhe teknologjive bashkëkohore;
- ❖ Fakulteti i gjuhëve, kulturave dhe komunikimit;
- ❖ Fakulteti i drejtësisë dhe
- ❖ Fakulteti administrimit publik dhe shkencave Politike.

Mësimdhënia e gjuhëve (ofrohet nga Qendra e gjuhëve), shkathtësitë e TI (ofrohen nga Qendra për eLearning) dhe lëndët 'zgjedhore të lira' (ofrohen për të gjitha disiplinat), studentët kryesisht studiojnë në fakultetin e zgjedhur në fillim. Hulumtimi ndërmerret nga studentët dhe stafi në mënyrë individuale; hulumtimi kolektiv shpesh ndërmerret në marrëveshje me fakultetin, ose në kuadër të Institutit hulumtues (Max van der Stoel Research dhe Institutit të mjedisit dhe shëndetësisë) dhe Zyrës për hulumtim.

3.1. Fakulteti i biznesit dhe ekonomisë

Fakulteti i biznesit dhe ekonomisë mbetet fakulteti më madh në nivel të Universitetit. Ai vazhdon të ofrojë programe mjaft atraktive në të tri ciklet, duke përfshirë programet e studimeve të integruara që sjellin studentët, biznesin dhe Universitetin në një përpjekje të përbashkët. Pjesa më e madhe e punës në mbështetje të këtyre programeve është bërë nga stafi akademik i B&E, duke punuar bashkërisht me Qendrën për zhvillimin e biznesit dhe këshilltarin e programit, Prof. Norbert Marx.

Gjatë periudhës së mbuluar nga ky raport, në Fakultetin e B&E u realizua pilot anketa – Vlerësimi i mësimdhënies. Në të u bë anketim me studentët për çdo lëndë në studimet deridiplomike në B&E. Zakonisht ky proces është moderuar nga një anëtar i menaxhmentit ekzekutiv ose një anëtar i ranguar lartë nga një fakultet tjetër. Komentet e studentëve ishin të thukëta dhe përmbajtësore. Ato në mënyrë anonime janë përcjellë tek mësimdhënësit. Ka pasur raporte të shumta për praktikën e mirë, por edhe sugjerime dhe kritika për zhvillim në të ardhmen.

Fakulteti është i kënaqur që ishte në gjendje për të hapur master programin në Menaxhment në kampusin e Shkupit gjatë kësaj periudhe. Një nga programet më të njohura të Fakultetit u vu në dispozicion për tregun e kryeqytetit.

Fakulteti gjithashtu ishte i ngazëlyer me organizimin e seminarit të veçantë për studentët në vitin e tretë në lëndën e kontabilitetit. Këto seminare i thelluan njohuritë dhe shkathtësitë e studentëve në këtë fushë të rëndësishme për zhvillimin e tyre profesional dhe arritjet e tyre u njohën me dhënie të një certifikate.

Fakulteti vazhdon të bëjë përpjekje të konsiderueshme për të rekrutuar studentë të rinj dhe për të vizituar shkollat e mesme lokale dhe rajonale, si pjesë e përpjekjeve promovuese të Universitetit. Gjithashtu, ekziston një iniciativë e përgjithshme në Fakultetin e biznesit dhe ekonomisë për të përmirësuar cilësinë dhe prezantimin e publikimeve akademike të personelit, në mënyrë që të kontribuojnë më shumë në profilin hulumtues të Universitetit dhe për të përhapur hulumtimin e Fakultetit.

3.2. Fakulteti i shkencave dhe teknologjive bashkëkohore

Qëllimi kryesor i Fakultetit të shkencave dhe teknologjive bashkëkohore mbetet forcimi i njohurive teorike me përvojën praktike. Fakulteti ka promovuar fuqishëm unitetin e praktikës dhe të studimit duke identifikuar, duke krijuar, dhe duke akredituar programe të reja akademike. Këto janë dizajnuar që të ndihmojnë në krijimin e të diplomuarve të gatshëm për tregun e punës ku shkathtësitë e të cilëve përputhen me sfidat praktike të punës moderne. Theksi i këtyre programeve është integrimi i përvojës me vendin e punës dhe i studimit në klasë/laborator. Fakulteti është i kënaqur me konstatimin se ruan një shkallë të lartë rajonale të punësimit për të diplomuarit nga fakulteti.

Për të promovuar bashkëpunim ndërkombëtar në fushën e arsimit, Fakulteti është duke punuar në përgatitjen për akreditimin e një programi të përbashkët me universitetin *University of Applied Research in Saarbrücken*, kompaninë APAV SEE – Shkup dhe *Fraunhofer Institute*; një iniciativë për diplomë të përbashkët me *Coventry University* është në proces. Në të njëjtën kohë Fakulteti vazhdon ta forcojë mobilitetin e stafit dhe të studentëve përmes shkëmbimit të studentëve në fushën e Erasmus+. Këtë vit mobiliteti është realizuar me *GJOVIK University* në Norvegji dhe *University of Twente* në Holandë. Për më shumë, në lëmin e studimeve të doktoratës, Fakulteti i SHTB gjatë vitit 2014/2015 ka mirëpritur profesorë të huaj, të dalluar, të cilët kanë mbajtur seminare shumë profesionale, me tendencat e fundit në lëmin e shkencave kompjuterike.

Fakulteti i shkencave dhe teknologjive bashkëkohore është angazhuar në përpjekje të shumta për promovim dhe rekrutim në Maqedoni, Kosovë dhe Shqipëri. SHTB gjithashtu ka mbështetur pjesëmarrjen stafit në konferenca dhe tryeza të rrumbullakëta, për të rritur njohuritë e tyre dhe për të ndërtuar kontakte profesionale. Në nivel të fakultetit ka mbajtur "grupet hulumtuese" të themeluara në vitin e kaluar. Brenda "grupeve hulumtuese", janë dorëzuar disa projekte hulumtuese për financim të jashtëm dhe një prej tyre ka fituar.

Fakulteti vazhdon të besojë se harmonizimi i politikave dhe procedurave është një element kyç në ofrimin efektiv dhe efikas të mësimin për studentët. Si objektivat për të ardhmen, kërkon të vazhdojë të ndërtojë lidhje të forta me grupet e interesit profesional; për të ruajtur punësimin e mirë të diplomuarve; dhe për të promovuar mësimin e bazuar në kompetenca në të gjitha ciklet.

3.3. Fakulteti i gjuhëve, kulturave dhe komunikimit

Fakulteti i gjuhëve, kulturave dhe komunikimit, vazhdon të ofrojë studime në katër fusha të lidhura gjerësisht: Gjuhë dhe letërsi shqipe; Gjuhë dhe letërsi angleze; Gjuhë dhe letërsi gjermane; dhe Komunikim ndërkombëtar.

Departamenti gjuhës angleze kishte një vit mjaft të mirë. Numri i studentëve të regjistruar në ciklin e tretë (studimet e doktoratës) ishte 8 studentë. Numri i studentëve të regjistruar në ciklin e dytë (master) kishte një rënie të lehtë ku 36 studentë u regjistruan në programin Mësimdhënia e gjuhës angleze. Në ciklin e parë, grupi i ri në Shkup vazhdoi në vitin 2014-15, por me numër të ulët të studentëve të regjistruar. Sidoqoftë, regjistrimet në kampusin e Tetovës mbetën solide me 50 studentë të regjistruar. U bënë përpjekje për të përmirësuar

cilësinë dhe sasinë e hulumtimit në departament dhe të gjithë mësime të plotësuar planin dyvjeçar për hulumtim i cili do të monitorohet nga afër. Pesë anëtarë të stafit të Departamentit të gjuhës angleze u promovuan në titull mësimesor - profesor inordinar gjatë vitit 2014-15 dhe se këta profesorë u akredituan me sukses për mentorë në studimet e doktoratës.

Departamenti i gjuhës gjermane gjithashtu kishte një vit mjaft të mirë, veçanërisht në studimet e ciklit të parë, me 22 studentë të regjistruar. Studimet e magjistraturës mbetën të dobëta në aspekt të regjistrimeve me më pak se 10 studentë. U publikua përmbledhja e punimeve nga konferenca *Language Learner Autonomy* e cila u mbajt në nëntor të vitit 2013; Departamenti i gjuhës gjermane vazhdon të gëzojë një bashkëpunim fitimprurës me Universitetin për Edukim në Zug / Lucern, Zvicër.

Departamenti i komunikimit ka vazhduar të tërheqë studentë të rinj në programin e ciklit të parë *komunikim ndërkombëtar* me 41 studentë të regjistruar në vitin akademik 2014-15 në të dy kampuset Tetovë dhe Shkup. Qëndrueshmëria e ofertës akademike të rishikuar kështu është konfirmuar. Shefi i Komunikimit ka vazhduar të jetë tepër aktiv në mbështetjen e aktiviteteve hulumtuese të fakultetit GJKK përmes drejtimit të Institutit Max van der Stoel; përmbledhja e punimeve nga konferenca Sfidat bashkëkohore të multikulturalizmit dhe politikës gjuhësore të mbajtur në maj të vitit 2014 u botuan gjatë semestrit pranveror 2015.

Departamenti i gjuhës shqipe mirëpriti gjeneratën e re të studentëve të doktoratës me 3 studentë të regjistruar në vitin 2014-15. Sidoqoftë, në ciklin e parë kishte pak aplikantë dhe në vitin 2014-15 nuk u hap grupi. Departamenti i gjuhës shqipe aktualisht është duke vlerësuar ofertën akademike dhe planifikon që t'i risë regjistrimet në ciklin e dytë dhe të tretë.

Viti 2014-15 ishte vit i konsolidimit i fakultetit të GJKK. U testua sistemi i ri për vlerësim të hulumtimit në promovime të ndryshme brenda fakultetit në semestrin dimëror 2014. Kampionët e rinj të cilësisë vizituan fakultetin gjatë vitit 2014 dhe ofruan këshilla të dobishme për zhvillim në të ardhmen. Instrumenti i sigurimit të cilësisë u përforcua me aktivimin e suksesshëm të ekipit të cilësisë së fakultetit të GJKK. Fakulteti gjithashtu vazhdoi të ofrojë një varg të mundësive për mobilitet për studentë nëpërmjet skemës së Erasmus+.

3.4. Fakulteti i drejtësisë

Fakulteti i drejtësisë ofron studime në të gjitha tri ciklet me theks të veçantë në të *drejtën ndërkombëtare, të drejtën civile dhe të drejtën penale*.

Gjatë vitit që mbulohet nga ky raport, Fakulteti i drejtësisë ka pasur një vit të arriturave të ndryshme. Arritja e parë e madhe ishte hapja e programit në gjuhën turke. Kjo risi lejoi Universitetin për të diversifikuar ofertat e saj në programet studimore, ndërsa në mënyrë të konsiderueshme ka zgjeruar familjen e UEJL-së duke përfshirë studentë të rinj turq. Fakulteti është gjithashtu i kënaqur me interesin e një grupi shtesë të studentëve turq që kanë aplikuar për t'u bashkuar (si studentë të transferimit) nga ata tashmë të regjistruar në UEJL.

Arritje shtesë ishin themelimi dhe funksionimi i ekipeve të sigurimit të cilësisë së Fakultetit, dhe takimet me palët e interesuara të jashtme.

Fakulteti ishte me fat, që në fillim të kësaj periudhe, për të mirëpritur këshilla të ekspertëve të Prof. Sasha Nikshiq dhe Prof. Davor Babiq – që të dytë nga Universiteti i Zagrebit - të cilët vizituan Fakultetin dhe realizuan rishikimin e jashtëm të programeve. Raporti i plotë iu është shpërndarë të gjithë anëtarëve të stafit të Fakultetit dhe do të shërbejë si një gurthemel për zhvillimin e prioriteteve dhe programeve të Fakultetit .

Ngjarja më e rëndësishme në vitin e mbuluar nga ky raport ka qenë mbajtja e konferencës me titull "Trashëgimia e Magna Charta-së 1215 për Ballkanin Perëndimor." Mbajtur më 17 qershor 2015, për të përkujtuar tetëqind vjetorin e këtij dokumenti themelor ligjor, në konferencë u paraqitën dokumente të shumta shkencore nga studiues kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Ambasadorët e Mbretërisë së Bashkuar dhe Shteteve të Bashkuara ishin të dy të pranishëm dhe patën fjalë përshëndetëse, siç bëri i Ministri i Drejtësisë së Republikës së Maqedonisë.

3.5. Fakulteti i administrimit publik dhe shkencave politike

Fakulteti i administrimit publik dhe shkencave politike ka vazhduar të ofrojë programe studimore në lëmin e shkence politike, marrëdhënieve ndërkombëtare dhe shërbimet e administrimit publik dhe qeverisjes. Ofron studime në tri ciklet e studimit.

Theks të veçantë në Fakultetin e APSHP këtë vit është kushtuar ndërkombëtarizimit. Drejt këtij qëllimi Fakulteti ndërmori iniciativa të shumta. Fakulteti ka nënshkruar një memorandum bashkëpunimi me Shkollën ndërkombëtare për studime sociale dhe biznes në Celje të Sllovenisë. Në mënyrë të ngjashme, është nënshkruar një memorandum mirëkuptimi për bashkëpunim në mes të Fakultetit dhe Kolegjit universitar *Dag Hammarskjöld* për marrëdhënie ndërkombëtare dhe Diplomacisë në Kroaci. Dekani e APSHP ka dorëzuar kërkesën për anëtarësim të UEJL-së në nismën kroate për bashkëpunim universitar, Qendrën Universitare Botërore, në Dubrovnik.

Fakulteti APSHP gjithashtu ka punuar në disa projekte në bashkëpunim me Institutin Max van der Stoel Research . Në mesin e përpjekjeve të tjera nga ky bashkëpunim erdhi një ligjërues nga Universiteti i Lubjanës për të folur në UEJL lidhur me Anketën evropiane për vlerën. Fakulteti gjithashtu ka organizuar një tryezë të rumbullakët universitare të gjerë mbi Hulumtim empirik vs. normativ.

Fakulteti ka ndërmarrë iniciativa të rëndësishme të brendshme për të përmirësuar standardet e komunikimit në mes stafit dhe studentëve. Kishte një përpjekje të përtërirë për të bërë të sigurt se janë respektuar të gjitha orët e konsultimit; se ankesat e studentëve janë trajtuar në mënyrë "të hapur"; dhe se grupet e specializuara nga disipinat ndryshme janë zhvilluar pa probleme dhe me dokumentacionin e duhur. Së fundi, i gjithë stafi APSHP janë angazhuar në rekrutimin e studentëve të rinj dhe promovimin e Universitetit.

3.6. Qendra e gjuhëve

Qendra e gjuhëve (QGJ) ka përgatitur një ofertë të re akademike për programet në gjuhën angleze dhe gjuhën maqedonase, ku syllabuset për lëndët anglishtja e përgjithshme dhe anglishtja për qëllime specifike (ESP) janë rishikuar për të arritur fokus më të madh në komponentët profesionalë. Për këtë qëllim, materialet shtesë dhe fletët e punës janë krijuar

për t'u përdorur së bashku me librin. Lëndët tjera të cilat ofrohen nëpërmjet QGJ dhe që kanë ngjallë interes ndërmjet studentëve janë (gjuha frënge, gjermane, italiane dhe gjuha shqipe për qëllime specifike).

Ka pasur një kontribut të rëndësishëm në profilin e hulumtimit të Universitetit nga ana e anëtarëve të stafit QGJ përmes rritjes së numrit të publikimeve dhe ndarjen efikase të buxhetit për hulumtim.

Përveç rolit akademik, QGJ vazhdoi me aktivitetet për promovimin e Universitetit përmes organizimit të ngjarjeve të tilla si, për shembull, konkursin kombëtar për ese me më shumë se 500 pjesëmarrës, kampin e gjuhës angleze dhe Panairin e gjuhëve. Përpjekjet për qasje deri tek komuniteti për diversifikimin e të ardhurave të pavarura të QGJ përfshijnë: organizimin e kursit CELTA, seanca testimi TOEFL ITP, seanca paratestimi IELTS, kurse të gjuhës për stafin në Ambasadën amerikane dhe kontratën për certifikatë të njohjes së gjuhës të njohur ndërkombëtarisht – BULLATS.

3.7. Qendra eLearning

Qendra eLearning vazhdoi misionin e saj për të siguruar mbështetje të konsiderueshme teknologjike në Universitet nga një perspektivë akademike. Ndoshta elementi më i rëndësishëm i kësaj pune është mirëmbajtja dhe operimi i sistemit të menaxhimit të të mësuarit të Universitetit LIBRI. Ky sistem i mundëson stafit akademik për çdo orë në Universitet të postojnë programet mësimore të tyre, të ngarkojnë dokumente, të ndajnë hyperlinks, të menaxhojnë dropboxes dhe mundësitë e tjera mësimore të ngjashme në një burim qendror elektronik. Gjithsej, për periudhën që mbulohet nga ky raport, 737 orë mësimore kanë qenë të pranishme në LIBRI.

Qendra eLearning gjithashtu ka një prani në klasë, si dhe disa prej lëndëve "zgjedhore të lira" në nivel të universitetit janë organizuar përmes Qendrës eLearning. Për të qenë më specifik, në nivel universiteti në studimet deridiplomike tre lëndë janë ofruar (TI shkathtësi, Excel i avancuar, dhe Access i avancuar) ku rreth 600 studentë kanë ndjekur këto lëndë dhe në studimet postdiplomike dy lëndë (Kapitujt të zgjedhur për TI dhe Kapitujt të zgjedhur për procesim të të dhënave statistikore) ishin marrë nga rreth 170 studentë.

Stafit të Universitetit është ofruar trajnim përmes Qendrës eLearning. Dyzet anëtarët e stafit kanë ndjekur kursin e trajnimit për Google Forms; dyzet e një anëtarët e stafit u trajnuan në Prezzi; dhe pesëdhjetënjë anëtarë të stafit administrativ janë trajnuar për Certifikatën ECDL. Së fundi, Qendra eLearning në bashkëpunim me Fakultetin SHTB kanë mirëpritur mësuesit e shkollave të mesme për trajnim në temë "TI në mbështetje të mësimdhënies dhe të nxënit".

Qendra eLearning gjithashtu ofron asistencë të konsiderueshme në të gjithë Universitetin rreth dizajnit, përgatitjes dhe shtypjen e materialeve të nevojshme, qofshin ato certifikata për pjesëmarrje në konferencë, postera promovues, kartela për identifikim, apo nevoja të tjera që kanë të bëjnë me shtypjen kompjuterike.

4. Sigurimi i cilësisë

Në lidhje me sigurimin e cilësisë, aktivitetet mund të ndahet në dy seksione: përfshirjen në dhe përdorimin e proceseve të jashtme dhe të brendshme të sistemeve dhe kulturës të cilësisë.

Të gjitha shqyrtimet e jashtme të programeve, duke përdorur ekspertë ndërkombëtarë, kanë përfunduar dhe rekomandimet e tyre nga raportet janë përfshirë në plan veprimet e fakulteteve përkatëse. Përveç kësaj, një rishikim i Departamentit të gjuhës shqipe në kuadër të Fakultetit të gjuhëve, kulturave dhe komunikimit ka filluar, për të vlerësuar aktivitetet e ardhshme të kësaj njësie. Ky veprim është në vazhdim e sipër.

Në janar të vitit 2015, ndryshime të mëtejshme në Ligjin arsimin e lartë kërkuan rishikimin urgjent të të gjitha programeve studimore, duke kërkuar harmonizim të rëndësishëm me programet e universiteteve në pozita të larta sipas rangimit ndërkombëtar, për riakreditim nga fillimi i vitit të ardhshëm akademik. Gjithashtu iu dhanë kompetenca të reja Bordit të akreditimit dhe llerësimit për të menaxhuar këtë proces dhe procedurat e tjera të cilësisë. Anëtarë të stafit në të gjitha fakultetet filluan këtë proces të ndërlikuar menjëherë. Megjithatë, pjesë të mëdha të ligjit që përfshijnë këtë kërkesë janë shtyrë për më vonë dhe që atëherë, ka pasur shumë pak aktivitet ose përkrahje nga ky organ kombëtar. Duhet të theksohet se ka pasur vonesë të konsiderueshme në akreditimin e mentorëve të rinj në studimet e magjistraturës, të cilat mund të ndikojnë seriozisht në cilësinë e kësaj dispozite.

Në lidhje me të dhënat e jashtme për nxënien dhe mësimdhënien, Forumi i cilësisë i 9 i EUA-së për nxënien dhe mësimdhënien ishte një mundësi për të dëgjuar në lidhje me praktikën e fundit më të mirë, gjithë që Universiteti ka promovuar tek stafi mësimdhënës. Përveç kësaj, përfaqësuesit e Unionit Studentor Evropian kanë dhënë kontribut të dobishëm në programin tonë të trajnimit në janar në këtë drejtim për të nënvizuar tendencat kryesore - studentët si partnerë të ardhshëm.

Në drejtim të strukturave të cilësisë, Bordi i Universitetit ka bërë monitorimin e rregullt të planeve të Universitetit dhe ka mbikëqyruar zbatimin e të dhënave të verifikueshme të kontrollit të cilësisë në fushat e menaxhimit të performancës, auditimet financiare të Universitetit, planifikimin, vlerësimin e stafit dhe proceset e punësimit, menaxhimit të performancës, dhe zhvillimin akademik. Komiteti për çështje të stafit dhe Komiteti për auditim dhe menaxhim të rrezikut kanë diskutuar dhe vlerësuar këto të dhëna.

Rregullorja e rishikuar për rangim, për rroga dhe kompensime të tjera, e miratuar nga Bordi në nëntor 2014, gjithashtu u implementua. Viti i parë i kontratës së re të menaxhimit të performancës akademike u përfundua me dekanët dhe stafin akademik ku vlerësohet performanca hulumtuese veçmas në përputhje me planet individuale të hulumtimit dhe rezultatet nga hulumtimi janë matur. Ka pasur edhe kërkesa të reja kontraktuale, në përputhje me periudhat akademike për promovimin dhe planifikimit afatgjatë për karrierën individuale dhe zhvillimin e fakultetit. Një rishikim i rregulloreve është në vazhdim, duke filluar me rregulloren për hulumtim, promovim dhe një pako e rregulloreve për menaxhim të performancës, si dhe rishikimin e disa rregulloreve të qeverisjes të tilla si rregullorja për funksionimin e Këshillit të fakultetit.

Vitin e kaluar u fut edhe një fokus i ri i rëndësishëm në menaxhimin e cilësisë së stafit akademik dhe administrativ, bazuar në monitorimin e prezencës dhe përdorimin e kohës së punës, si dhe u vu në përdorim sistemi i ri "e-scheduling". Ka përmirësim të vazhdueshëm dhe zhvillim të këtyre strategjive dhe proceseve.

Universiteti edhe një herë u riakreditua me ISO 9001:2008 - standard i jashtëm për menaxhim të performancës. Vitin e kaluar, çdo departament administrativ kryen një ushtrim të vlerësimit të tillë

si një anketë, kuti për komente ose shqyrtim të aktivitetit në fund të procesit. Rezultatet ishin shumë pozitive, plus ka pasur tregues të dobishëm të pikave të presionit të shërbimit ose nevojë për përmirësim. Përveç kësaj, nga Raporti vjetor për punësim shihet se vendet e lira administrative janë plotësuar sipas një procesi të hapur dhe transparent, me çështjet e përshkruara për shqyrtim. Është realizuar edhe një numër i vogël i zgjedhjeve për tituj akademikë në përputhje me një proces transparent.

Gjatë muajit mars u realizua vizita e dytë nga Kampionët e cilësisë, të cilët bënë një vlerësim më të thellë të Fakultetit të drejtësisë, APSHP dhe SHTB, si dhe një vlerësim të strukturave të cilësisë dhe shërbimeve studentore. Raporti përfundimtar dha këshilla shumë të dobishme për shqyrtim dhe një raport progresi do të bëhet në janar. Përveç kësaj, në përputhje me këshillat e pranuar nga kampionët e cilësisë, Universiteti ka vendosur për të ringjallur ekipet akademike të sigurimit të cilësisë për të forcuar rolin e tyre të punës dhe për të përmbushur kërkesat ligjore për një organ në nivel të departamentit për të siguruar besimin e publikut dhe besimit. Ka pasur pak progres fillestar në këtë aspekt.

Ka pasur ndryshime në proceset e brendshme të cilësisë vitin e kaluar. Numri i vëzhgimeve mësimore u zvogëlua dhe vetëm ata anëtarë të stafit të ri ose që ishin në procesin e promovimit janë vëzhguar sipas procesit të paralajmëruar. Kjo lidhet me vendimin që dekanët duhet të përqendrohen në vëzhgimet e paparalajmëruara (ad hoc), të cilat janë ndjerë të jenë disi më të "natyrshme". Zyra e cilësisë ka koordinuar këtë proces dhe përgatiti një raport të plotë për tërë vitin, raporti vlerësues mbi vlerën relative. Pas marrjes në konsideratë, një sistem i ri, i vëzhgimeve të paralajmërua që gjithashtu lidhet me vlerësimin nga kolegët, gjithashtu do të implementohet si pilot projekt. Sa i përket vlerësimit nga studentët, përveç vlerësimit që ato e bëjnë në semestrin e dytë për proceset akademike dhe administrative, këtë vit gjithashtu, kishte një pilot projekt me studentët nga semestri i parë (anketa – vlerësimi i mësimdhënies nga studentët), ku lehtësuesit grumbulluan komentet nga studentët në çdo orë mësimore dhe komente në mënyrë anonime u prezantuan tek mësimdhënësit, të shoqëruar me raport përmbledhës për fakultetin. Ky proces u dëshmuar të jetë mjaft konstruktiv dhe rekomandohet që të zgjerohet. Ndërkohë, fakulteti planifikon që të rishikojë komentet e studentëve këtë me mësimdhënësit. Zyra e cilësisë gjithashtu ka ofruar mbështetje për Parlamentin studentor gjatë zgjedhjeve dhe zhvillimit të aktiviteteve.

Në aspekt të menaxhimit dhe sigurimit të cilësisë, disa pika kyçe për zhvillim në vitin e ardhshëm do të jenë: lidhje më të mira me Bordin e akreditimit dhe vlerësimit me kontribut në legjislacionin e rishikuar ashtu siç do të ftohemi; shfrytëzim të rekomandimeve të kampionëve të cilësisë; zhvillim të mëtejshëm të ekipeve të cilësisë së fakulteteve/qendrave; përmirësim të disponueshmërisë dhe cilësisë të mentorëve hulumtues; përforcim të cilësisë së hulumtimit dhe promovimit; ri-vlerësim të rolit dhe përgjegjësisë në pajtim me Rregulloren për rangim, rroga dhe kompensime tjera; të vazhdohet me përforcimin e pjesës kryesore të mësimdhënies dhe nxënies nëpërmjet skemës së rishikuar të vëzhgimit të mësimdhënies dhe zgjerimi të pilot skemës së T.A.P; të ruhet dhe përmirësohet përdorimi i të dhënave; përmirësim të sistemeve për kontrollim të prezencës dhe e-scheduling; dhe ruajtjen dhe forcimin në përgjithësi të transparencës dhe qëndrueshmërisë së politikave dhe procedurave në mënyrë që ata të kenë vlerë të vërtetë dhe të qëndrueshme e cila krijon mjedis punë pozitiv dhe produktiv.

5. Mësimdhënia dhe të mësuarit

5.1. Programet dhe statusi

Të pesë fakultet e UEJL-së kanë ofruar programe studimore në ciklin e parë, të dytë dhe të tretë gjatë periudhës së mbuluar nga ky raport. Të gjitha kurrikulat janë miratuar nga Ministria e arsimit. Mentorët e studentëve të doktoratës kanë marrë edhe akreditimin qeveritar për të ofruar mentorim në studimet e doktoratës. Duket se ka propozime në Qeveri për ta zgjeruar këtë proces të akreditimit të mentorimit në ciklin e dytë.

Të dhënat e paraqitura më poshtë vlerësojnë ciklin e jetës studentore, nga regjistrimi deri në diplomim.


5.2. Regjistrimi i studentëve

Siç mund të shihet në tabelën 1, numri i përgjithshëm i studentëve të regjistruar ka rënie të lehtë në mes viteve akademike 2013-2014 dhe 2014-2015, në përgjithësi kishte 1011 studentë të regjistruar në vitin akademik 2014-2015.

Viti akademik	Regjistrimet
2012/2013	1165
2013/2014	1257
2014/2015	1011
Gjithsej	3433

TABELA 1. NUMRI I PËRGJITHSHËM I REGJISTRIMEVE SIPAS VITEVE AKADEMIKE

Të dhënat për regjistrimet të shënuara në grafikonin 1 tregojnë regjistrimet sipas gjuhës së studimit; të dhënat tregojnë se shpërndarja e përgjithshme e regjistrimit sipas gjuhës së studimit mbetet relativisht konsistente me vitet e mëparshme. Numri i regjistrimeve në gjuhën shqipe është shumë më i lartë se të dy gjuhët tjera, me anglishten që përfaqëson grupin e dytë kurse gjuha maqedonase e treta.



GRAPH 1. NUMRI I PËRGJITHSHËM I REGJISTRIMEVE SIPAS GJUHËS SË STUDIMIT

Tabela 2, tregon numrin e përgjithshëm të regjistrimeve sipas fakulteteve për tri vitet e fundit. Vetëm një fakultet—Fakulteti i drejtësisë — ka shënuar rritje të numrit të regjistrimeve në mes vitit akademik 2013-2014 dhe 2014-2015. Fakulteti me diskrepancën më të madhe në mes të atyre viteve akademike ishte Fakulteti i biznesit dhe ekonomisë, me një rënie prej 76 të regjistruarve.

Fakulteti	2012/2013	2013/2014	2014/2015
BE	290	328	252
SHTB	175	235	169
Drejtësi	206	242	249
GJKK	247	247	177
APSHP	247	205	164
Gjithsej	1165	1257	1011

TABELA 2. NUMRI I PËRGJITHSHËM I REGJISTRIMEVE SIPAS FAKULTETEVE

5.3. Kalueshmëria e studentëve

Kalueshmëria e studentëve është një sfidë kyçe për çdo universitet. Kalueshmëria e suksesshme i referohet aftësisë së studentëve për të qëndruar aktivë në programet në të cilat ata janë regjistruar, dhe për të arritur progres të vazhdueshëm akademik me kurrikulat e tyre të ndryshme. Të dhënat e përfshira në tabelat 3 dhe 4 janë në përputhje me të dhënat e ngjashme nga vitet e kaluara: UEJL bën një punë të mirë për të siguruar kalueshmërinë nga viti i parë dhe në vitin e dytë, por kalueshmëria në vitin e tretë vazhdon të jetë më e ulët sesa duhet të jetë.

Gjenerata 2012/13	Student të rregullt 2012/13	Kalueshmëria 2013/14		Kalueshmëria 2014/15	
Fakultetet	Studentët	Kalueshmëria në vitin e 2	%	Kalueshmëria në vitin e 3	%
BE	160	139	86.88%	105	65.63%
SHTB	118	97	82.20%	78	66.10%
Drejtësi	144	128	88.89%	102	70.83%
GJKK	118	106	89.83%	92	77.97%
APSHP	122	107	87.70%	96	78.69%


TABELA 3. KALUESHMËRIA PËR GJENERATËN 2012/13

Gjenerata 2013/14	Student të rregullt 2013/14	Kalueshmëria 2014/15		Kalueshmëria 2015/16	
Fakultetet	Studentët	Kalueshmëria në vitin e 2	%	Kalueshmëria në vitin e 3	%
BE	149	132	88.59%	98	65.77%
SHTB	116	96	82.76%	89	76.72%
Drejtësi	133	96	72.18%	79	59.40%
APSHP	80	70	87.50%	61	76.25%
GJKK	131	123	93.89%	108	82.44%
Total	609	517	84.98%	435	72.12%

TABELA 4 KALUESHMËRIA PËR GJENERATËN 2013/14

5.4. Diplomimi i studentëve

Grafikoni 2, paraqet normat krahasuese të diplomimit për gjeneratën 2012/2013, sipas fakulteteve. Përqindja më e lartë e diplomimit në kohë ishte në Fakultetin e gjuhëve, kulturave dhe komunikimit, me 38.98%; përqindja më e ulët ishte në Fakultetin e shkencave dhe teknologjive bashkëkohore, me 19.49%. Shkalla e diplomimit në kohë në nivel të Universitetit për gjeneratën 2012/2013 është 27,49%, e cila është zhgënjyese e ulët. Gjithashtu duhet të konstatohet se studentët mund të mos diplomojnë në kohë për dy arsye akademike dhe administrative (p.sh. pa mundësi të paguajë pagesën e shkollimit).



GRAF 2. SHKALLA E DIPLOMIT PËR GJENERATËN 2012/13

5.5. Qendra e karrierës dhe punësueshmëria

Qendra e karrierës së UEJL-së është burimi kryesor për studentët që realizojnë punën praktike të tyre apo bëjnë kërkim për punësim. Qendra organizon Panairin vjetor të karrierës, në të cilën organizata dhe kompani rekrutojnë studentë dhe sapodiplomuar të UEJL-së. Gjatë këshillimit dhe shërbimit i këshillon studentët për procesin e kërkimit të punësimit, i shpërndan konkurset për pozitat që kërkohen dhe ofron trajnime për çështje të tilla si plotësimi i kërkesës për punë dhe të shkruarit e CV. Gjithashtu në bashkëpunim të ngushtë me Qendrën e zhvillimit të biznesit siguron qasje tek bizneset dhe partnerët tjerë të jashtëm për mundësi të bashkëpunimit dhe realizimit të stazhimit.

Çdo vit Qendra e karrierës realizon një anketë për punësimin e të diplomuarve për gjeneratën e vitit të kaluar dhe përdor këto të dhëna për të formuar një profil për punësimin e të diplomuarve të UEJL-së. Të dhënat e mëposhtme janë nxjerrë nga kjo anketë. Është e rëndësishme të theksohet se të gjitha të dhënat e raportuara këtu janë të bazuara në përgjigjet e të anketuarve të cilët ishin të gatshëm të përgjigjen dhe nuk përfaqësojnë ose përfshijnë ata që nuk zgjedhën të marrin pjesë.

Shkalla e përgjithshme e punësimit të të diplomuarve të UEJL-së në vitin 2014 është 40% dhe shkalla e papunësisë është 60%. Sipas të diplomuarve të punësuar, 84% prej tyre janë të punësuar me orar të plotë, 9% janë me kohë të pjesshme, 6% e tyre janë të vetëpunësuar (ata kanë vetë biznesin e tyre), dhe 1% janë duke bërë një stazh. Nga numri i përgjithshëm i studentëve të papunë, 24% kanë treguar se ata janë të papunë me përcaktim, kështu që shkalla aktuale e papunësisë të të diplomuarve të UEJL-së vlerësohet të jetë në afërsi të 19%.

Kur vlerësohet në nivel të fakulteteve shkalla e punësimit/e papunësisë është si në vijim: Fakulteti i biznesit dhe ekonomisë: 49% të punësuar/51% të papunë; Fakulteti i shkencave dhe teknologjive bashkëkohore: 59% të punësuar/41% të papunë; Fakulteti i drejtësisë: 36% të punësuar, 64% të papunë; Fakulteti i gjuhëve, kulturave dhe komunikimit: 48% të punësuar, 52% të papunë; dhe Fakulteti i administrimit publik dhe shkencave politike: 46% të punësuar, dhe 54% të papunë. Kështu, shkalla më e lartë e papunësisë në nivel të Universitetit është në mesin e të diplomuarve të Fakultetit të drejtësisë, dhe shkalla më e lartë e punësimit në universitet është ndër të diplomuarit e Fakultetit të shkencave dhe teknologjive bashkëkohore.

Është inkurajuese të theksohet se tendencat e fundit kanë vazhduar në korrelacion ndërmjet notës mesatare dhe punësimit. Sondazhi më i fundit për punësim gjeti se ata me notë mesatare 9-10 kishin një shkallë 61% të punësimit/ 39% të papunë dhe ata me notë mesatare kumulative 6-7 kishin të njëjtin raport 44%/56%. Kjo paraqet një ndryshim inkurajues nga vitet e mëparshme, në të cilën nuk kishte asnjë korrelacion të qartë në mes të notës mesatare të lartë dhe punësimit.

Sipas anketës, shkalla e papunësisë të të diplomuarve me studim në gjuhën shqipe është 57% dhe shkalla e papunësisë të të diplomuarve me studim në gjuhën maqedonase 36%. Nacionalitet tjera shënojnë një shkallë të papunësisë prej 64%.

5.6. Asociacioni Alumni

Asociacioni Alumni i UEJL-së është definuar në Statutin e Universitetit, por nuk ekziston në kuptimin funksional. Organizimi i Asociacionit Alumni konsiderohet si një nga sfidat e rëndësishme të Universitetit, ku në mënyrë efektive do të ofrojë mundësi të vlefshme për të mbetur të lidhur me të diplomuarit tonë.

Është inkurajues fakti se kur Universiteti organizoi takimin e Alumnit në Maqedoni dhe Kosovë pjesëmarrja në këto ngjarje sociale ishte e mirë. Të diplomuarit tanë ruajnë vullnetin e mirë për institucionin e tyre dhe kjo duhet të kultivohet si një burim i këshillave të vlefshme, mbështetje, dhe promovimin në vitet që do të vijnë.

6. Hulumtimi

Zyra për hulumtim këshillon dhe mbështet aktivitetet hulumtuese të Universitetit. Duke punuar në bashkëpunim të ngushtë me institutet hulumtuese, Zyra për hulumtim ofron mbështetje financiare për stafin akademik për të marrë pjesë në konferenca profesionale, këshillon hulumtuesit se si më mirë të paraqesin punën e tyre para publikut, mbështet propozimin e kërkesave për grante e përfshirje në projekte dhe ofron ndihmë kundër problemit të botimit të rrejtshëm apo abuziv. Zyra për hulumtim gjithashtu mbështet punën e Komitetit qendror për hulumtim, i cili vlerëson botimet e anëtarëve të stafit akademik dhe bën alokimin e "pikëve" në drejtim të promovimit në thirrje akademike. Së fundi, Zyra për hulumtim organizon redaktimin dhe publikimin e revistës kryesore hulumtues të Universitetit, *SEEU Review*.

Zyra për hulumtim këtë vit udhëhoqi një përpjekje të madhe për të frymëzuar dhe të ndjekur përpjekjet hulumtuese të stafit. Këtë vit Zyra për hulumtim për herë të parë udhëhoqi programin e titulluar 'Plani individual për hulumtim', në të cilin çdo anëtar i stafit akademik u takua menaxherin e linjës së tij ose të asaj dhe u pajtuan për një seri të caktuar të objektivave hulumtuese për vitin 2014-2015. Pasi plani të dakordohet me dekanin ose drejtorin gjegjës, çdo anëtar i stafit akademik ishte i pajtimit për një buxhet përkrahës deri 700 euro në përkrahje të hulumtimit. Zyra për hulumtim ka aprovuar mbi 40.000 euro në përkrahje të stafit akademik për pjesëmarrje në konferenca — pjesa më e madhe buxhetit ishte për anëtarët e stafit të Qendrës së gjuhëve dhe më pak kanë shfrytëzuar anëtarët e Fakultetit të drejtësisë.

Komiteti qendror për hulumtim është takuar shtatë herë gjatë vitit 2014-2015, duke rishikuar aktivitetet hulumtuese për 16 anëtarë të stafit të cilët ishin paraparë për promovim të titujve akademikë.

Në numrin e *SEEU Review* u botua një përmbledhje e punimeve nga Konferenca Ambasadorëve të Londrës nga viti i kaluar. Kjo përmbledhje (Vol. 10, Nr. 1) është, në përputhje me edicionet e mëparshme të *SEEU Review*, pa pagesë në dispozicion për të gjithë në mbarë botën në faqen e internetit të UEJL-së. Vëllimi përmbledhës i punimeve e mëdha nga kjo konferencë dhe u botua njëkohësisht në kopje në të shtypur, botime elektronike dhe versionet elektronike. Dy vëllimet e ardhshme për vitin 2016 janë shpallur tashmë: Vol. 11, nr. 1 do të paraqesë punimet e Konferencës Magna Carta, dhe Vol. 11, Nr. 2 do të paraqesë një përmbledhje të përgjithshme të punimeve.

Përpjekja më e rëndësishme e Zyrës për Hulumtim gjatë vitit që mbulohet nga ky raport ka qenë arritja e certifikimit nga HRS4R. Kjo përpjekje e Bashkimit Evropian/Euraxess kërkon të identifikojë dhe ndihmojë institucionet që sigurojnë cilësi në hulumtim dhe drejtësi në mbështetjen e tyre formale të aktiviteteve hulumtuese. UEJL është krenare që e kanë marrë këtë vërtetim zyrtar si përfaqësues për përsosmëri në hulumtim.

6.1. Instituti hulumtues "Max Van der Stoel"

Instituti ka pranuar rolin qendror në marrjen përsipër si organizator i konferencave në UEJL, si platforma për hulumtim dhe për iniciimin e hulumtimeve më cilësore dhe zhvillimin e kapaciteteve kërkimore. Instituti ka mbetur i vendosur për të inkurajuar fakultetet si bashkorganizatorët e konferencave shkencore për të sjellë në rol më të rëndësishëm dhe të bëjë dimension më aktiv që fakultetet të iniciojnë kërkime përmes institutit. Konferenca vjetore e institutit në temë "Roli i shoqërisë civile në transformimin politik dhe shoqëror - Perspektiva nga Polonia dhe Maqedonia" u organizua më 30 prill të vitit 2015, e bashkorganizuar nga NDI, dhe me mbështetjen e Ambasadës polake dhe USAID-i.

Në bashkëpunim me Qendrën Wilfried Martens për Studime Evropiane nga Brukseli dhe Fondacioni Konrad Adenauer, Instituti Max van der Stoel u bashkua me projektin "Cathedra Adenauer 2015" i cili paraqet një platformë shkencore dhe arsimore ndërkombëtare përmes të cilave studentët e rinj dhe shkencëtarët do të arrijnë kuptim më të gjerë të të gjitha aspekteve të rëndësishme të procesit të integritimit në BE. Gjatë periudhës së raportimit MVDSRI ishte bashkorganizator i serisë së tri konferencave: "Procesi i integritimit në BE të vendeve të Ballkanit Perëndimor në dritën e sfidave të fundit ekonomike dhe politike të Bashkimit Evropian"; "Trekëndëshi Rajonal Njohurive: Lidhja e arsimit të lartë, hulumtimi dhe inovacioni në mbështetje të zhvillimit rajonal dhe integritimit në BE" dhe " Të menduarit pa kufij: Migracioni dhe BE-ja, çfarë po ndodh në Evropë?"

Në bashkëpunim me Fakultetin e administrimit publik dhe shkencave politike nëpërmjet programit Erasmus + për shkëmbim të stafit më 9 shtator organizoi një seminar nga metodologjia e hulumtimit me Prof. Samo Uhan, nga Universiteti i Lubjanës me temë "Ndryshimet sociale në shoqëritë evropiane, të gjeturat e anketës sociale evropiane". Para kësaj më 17 qershor 2015 Instituti në bashkëpunim me Fakultetin e drejtësisë organizuan konferencën "Trashëgimia e Magna Carta-ës 1215 për Ballkanin Perëndimor"

Konferenca vjetore ndërkombëtare që u organizua nga instituti me ndihmën e Fakultetit të gjuhëve dhe të komunikimit në vitin 2014, në fund të verës 2015 pati një botim të suksesshëm të përmbledhjes së punimeve të konferencës "Sfidat bashkëkohore të multikulturalizmit dhe politikave gjuhësore".

Grupet e hulumtimit dhe anëtarët individualë të stafit ishin të përfshirë në mënyrë aktive në baza vullnetare pa asnjë mbështetje financiare. Çështja e mbështetjes për grupet kërkimore në nivel të Universitetit duhet të diskutohet në vitin 2015/16 në drejtim të njohjes së veprimtarisë së tyre në kuadër të fakultetit dhe formave të motivimit të tyre.

Dy nga grupet hulumtuese ndërdisiplinore të institutit kanë iniciuar dy aplikime për projekte hulumtuese. Për herë të parë Universiteti përmes institutit ka aplikuar në thirrjen e Kryesisë e Zhan Monet dhe propozimi është vlerësuar shumë lart; por për fat të keq, nuk i pranuan vetëm tre pikë në fund. Pragu financimit për këtë veprim ka qenë i vendosur në 84/100 dhe projekti i Institutit ka marrë 81/100 pikë dhe për këtë arsye nuk është zgjedhur për bashkëfinancim nga BE. Paralelisht me këtë, një nga grupet hulumtuese të institutit ka iniciuar dhe ka përgatitur një aplikim të projektit në thirrje të UNESCO-s për grante të diversiteteve kulturore. Propozimprojekti i institutit është përzgjedhur nga Ministria e Kulturës dhe Qeverisë në mesin e katër e projekteve më të mira për të përfaqësuar vendin në konkurrencë të mëtejshme. Fondi Ndërkombëtar për Diversitetin Kulturor të UNESCO-s, në vlerësimin e tij të parapërzgjedhjes ka renditur propozimprojektin e institutit në pozitën e parë dhe vendimi përfundimtar për projektet e përzgjedhura do të bëhet gjatë takimit të nëntë të rregullt të Komitetit Ndërqeveritar, që zhvillohet nga 14-16 dhjetori 2015 në selinë e UNESCO-s në Paris.

6.2. Instituti i mjedisit jetësor dhe shëndetit

Instituti i mjedisit jetësor ka ofruar për Universitetin ekspertizën për çështjet e efijencës së energjisë. Përveç segmentit të biomasës, ka raportime të rregullta krahasuese të efijencës së energjisë gjatë raporteve të vitit dhe raporteve javore të energjisë për efikasitetin nga sistemi fotovoltai.

Në kuadër të përpjekjeve për konsolidimin e punës normale të institutit, për herë të parë është themeluar Këshilli i institutit. Po ashtu ka pasur edhe një kthim të suksesshëm të lëndës zgjedhore të lirë "Menaxhimi mjedisor", ofruar nga instituti në nivel të studimeve deridiplomike që kishte qenë pezull për dy vitet e fundit.

Pas një pune intensive, është zhvilluar një lidhje funksionale dhe bashkëpunimi me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Si rezultat, një propozimprojekt i institutit për hulumtimin dhe hartimin e pilotprojektit për matjen e parametrave klimatikë është mbështetur financiarisht nga Ministria në kuadër të përpjekjeve për nxitjen e programeve arsimore dhe kërkimore për mbrojtjen e mjedisit. Ndërkohë, Ministria ka filluar ta kontaktojë institutin për opinionin profesional mbi disa fenomene dhe iniciativa të caktuara në Maqedoni në lidhje me çështjet mjedisore.

Më 27 janar 2015, instituti në bashkëpunim me Komunën e Tetovës ka lansuar një platformë të re të bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes së mjedisit për qëllime të zbatimit të plotë të "Planit të veprimit për energji të qëndrueshme" (SEAP). SEAP-i parasheh realizimin e studimit nga

Instituti i mjedisit dhe shëndetit në emetimin e gazeve serë. Rezultatet empirike do të ndihmojnë në masat e politikës dhe parandaluese kundër ndotjes së ajrit.

Në vjeshtë të vitit 2015, instituti ka filluar të bëjë përgatitjet e fundit për nisjen e një programi të ri trajnimi për mekanikë të energjisë dhe të efikasitetit të energjisë së ngrohjes qendrore.

6.3. Zyra për marrëdhënie ndërkombëtare

Zyra për marrëdhënie ndërkombëtare identifikon dhe mban mundësitë për bashkëpunim dhe aktivitet mes UEJL-së dhe institucioneve në mbarë botën. Zyra synon t'i ndërtojë mundësitë për bashkëpunim në tri fusha kryesore: marrëdhëniet institucionale dhe programore; projekte ndërkombëtare dhe mundësi; si dhe mobilitet të stafit dhe të studentëve. Këto përgjegjësi kanë të bëjnë direkt me dy aspektete: vizionin ndërkombëtar të themelimit të Universitetit si dhe tendencat e pashmangshme në arsimin e lartë për bashkëpunim më të madh ndërkombëtar.

Gjatë vitit të mbuluar nga ky raport Universiteti ka nënshkruar një memorandum mirëkuptimi me Universitetin e Bolonjës, për promovim të mundësive të mobilitetit të studentëve. Dy studentë nga ky institucion kanë kërkuar tashmë mundësi për mobilitet për të ardhur në UEJL. Përveç kësaj, 27 studentë të UEJL-së kanë marrë pjesë në programet e mobilitetit të mbështetura nga Erasmus + dhe 6 të tjerë e bënë këtë përmes projektit Basileus.

Fakulteti i drejtësisë gjatë këtij viti për herë të parë ofroi mundësinë e studimit në gjuhën turke, ku në vitin e parë akademik 2014-2015 u regjistruan 38 studentë dhe në mënyrë shtesë ka tërhequr edhe 17 studentë shtesë në vitin akademik 2015-2016.

Ndërkombëtarizimi mbetet një objektiv madhor i Universitetit, pasi që pasqyron proceset globale të bashkëpunimit ndërkulturor dhe multinacional. Gjithashtu është një komponentë e rëndësishme e misionit të Universitetit për të ndërtuar lidhje të forta me institucionet ndërkombëtare partnere dhe për të zhvilluar marrëdhënie të mira me komunitetin diplomatik ndërkombëtar të akredituar në Maqedoni.

7. Ndërmarrësia dhe zhvillimi

Universiteti i Evropës Juglindore operon një përpjekje të vazhdueshme për të ndërtuar, për të mirëmbajtur dhe për të thelluar marrëdhëniet e bashkëpunimit me komunitetet e biznesit dhe të financave. Universiteti vendos një vlerë të lartë në këto marrëdhënie, sepse me këta partnerë mund të krijojmë bashkëpunime nga ku mund të përfitojnë studentët tanë, stafi ynë, partnerët tanë dhe shoqëria më e gjerë.

Me qëllim që të përshtaten dhe të harmonizohen shërbimet e ndryshme profesionale dhe akademike që Universiteti mund të ofrojë për bizneset, këtë vit Universiteti ka formuar Komitetin për marrëdhënie me biznesin. Ky organ bashkon në takime mujore udhëheqësit e fushave përkatëse në të cilat Universiteti mund të ofrojë shërbime, analiza dhe mbështetje për kompanitë. Qëllimi i KMB është që t'i përmirësojë proceset e vendimmarrjes që përfshijnë marrëdhëniet biznesore të Universitetit dhe t'i bëjë ofertat tona koherente, të qarta dhe drejtpërdrejt të rëndësishme për interesat e partnerëve tanë aktualë apo të synuar.

Në vitin e mbuluar nga ky raport, Universiteti ka ndjekur ofertat për bizneset në katër sfera. E para prej këtyre është programi i studimeve të integruara. Këto studime të cilat kombinojnë mësimdhënien akademike në Universitet, ku 50% e programit mësimor realizohet në universitet dhe 50% në partner institucionet – bizneset, këto programe për herë të parë janë realizuar nga universitetet gjermane. Në vitin e mbuluar nga ky raport, Universiteti ka ndjekur ofertat për bizneset në katër sfera. E para prej këtyre është programi i studimeve të integruara. Këto studime të cilat kombinojnë mësimdhënien akademike në Universitet me gjysmën e programit mësimor që ofrohet në mjedisin e biznesit – puna praktike, këto lloje studimesh për herë të parë janë ofruar nga universitetet gjermane. Programi i studimeve të integruara në UEJL është mbështetur dhe këshilluar nga Dr. Norbert Marks, një ekspert nga Gjermania, prania e të cilit në UEJL është sponsorizuar bujarisht nga *Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ)*. Nga programi i studimeve të integruara përfitojnë kompanitë, pasi ata kanë ndikim të drejtpërdrejtë në përzgjedhjen e studentëve dhe programeve mësimore dhe kanë mundësi t'i trajnojnë studentët e rinj dhe ambiciozë. Në mënyrë të ngjashme, studentët përfitojnë nga bursat që sigurohen nga kompanitë, si dhe duke pasur kurrikulat më të orientuara kah tregu i punës në rajon; të diplomuarit e suksesshëm gjithashtu kanë mundësi që pas diplomimit të gjejnë punë në kompanitë në të cilat ata kanë bërë punën praktike.

Sfera e dytë e përpjekjes sipërmarrëse qëndron në ofrimin e trajnimeve nga ana e stafit të biznesit të UEJL-së, stafi ndërkombëtar dhe rajonal. Këto përpjekje trajnuese vazhdojnë tendencat tashmë të vendosura për të ndarë njohuritë dhe ekspertizën tonë me biznese të veçanta që kanë nevojë për trajnim të specializuar nga profesionistë të informuar. Në këtë cilësi, Universiteti ka krijuar një partneritet për të siguruar trajnime për Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim, një organizatë e madhe ndërkombëtare. Universiteti gjithashtu ofron trajnime edhe për kompanitë lokale të Maqedonisë, pjesërisht për të ndërtuar marrëdhënie të mira rajonale dhe për të forcuar aftësitë e punëtorëve dhe sipërmarrësve vendas.

Sfera e tretë e përpjekjeve qëndron në analizën korporative. Universiteti është në gjendje të ofrojë ekspertizë për kompanitë që nuk mund ta bëjnë vetë ose për kompanitë shumë të vogla për të përballuar vështirësitë në rrethana të tjera. UEJL duke pasur burimet akademike (njerëzore dhe materiale), pas dhënies së kësaj analize i bën këto kompani më tërheqëse. Llojet e analizave të kryera do të përfshijnë harmonizimin e buxhetit, vlerësimin e rrezikut, dizajnin korporativ dhe përpjekjet e tjera të ngjashme.

Aspekti i katërt i kësaj qasje qëndron në përpjekjet e Qendrës së karrierës për të ofruar mundësi efektive për punën praktike për studentët. Në nxitjen e KMB, Qendra e karrierës ka miratuar një strategji të shpërndarjes rajonale, krijimin e marrëdhënieve për stazhim në kompani të shumta në çdo pjesë të Maqedonisë. Kjo i lejon studentët tanë t'i zhvillojnë shkathtësitë e tyre në të gjithë vendin, por gjithashtu ta promovojnë Universitetin në rajonet që nuk janë tradicionalisht të përfaqësuar shumë në rekrutimin e studentëve. Kjo ka për qëllim, që në vitin ardhshëm akademik, Qendra e karrierës të thellojë këtë qasje rajonale me një fushatë më agresive për të vizituar të gjitha Qendrat e karrierës ose Qendrat udhëzuese në shkollat e mesme në Maqedoni.

Mbeten për t'u theksuar tri përpjekjet sipërmarrëse që kanë filluar para këtij raporti, por që vazhdojnë: Uni.com, Qendra për zhvillimin e biznesit, dhe Parku teknologjik i UEJL-së. Uni.com bashkon disa nga elementet më tradicionale që gjenerojnë të hyra në Universitet (Copyshop,

lavazhi, etj). Qendra për zhvillimin e biznesit ka një rol kryesor në ndihmën për zhvillimin e bizneseve lokale dhe nxitjen e marrëdhënieve me komunitetin e biznesit. Së fundi, Parku teknologjik i UEJL-së është një vend në kampusin e Tetovës që i sjell bizneset direkt në kampus, ku bashkon botën akademike dhe atë të korporatave në të dy aspektet reale dhe figurative.

Duhet pranuar se hijet e recesionit ekonomik vazhdojnë të bien mbi të gjitha këto përpjekje. Disa kompani kanë qenë të etshme të bashkëpunojnë ose t'i marrin trajnimet e ofruara, por e gjetën veten thjesht të paaftë në përballimin e shpenzimeve edhe më modeste. Mungesa e përpjekjeve të kompanive të shumta të suksesshme në fusha të ngjashme gjithashtu komplikon përpjekjet e UEJL-së, për të ndërtuar bashkëpunime; është e vështirë të unifikohen fushat e bashkëpunimit me industri të ndryshme në mënyrë të konsiderueshme. Së fundi, ne kemi identifikuar edhe nevojën për të lidhur aktivitetet tona për ndërtimin e marrëdhënieve të biznesit me oraret për planifikimin e buxheteve të korporatave. Duke kontaktuar kompanitë para se buxhetet e tyre jenë përfunduar, ne shpresojmë të bëhen oferta që janë menjëherë vepruese, në vend që kompanitë të presin për vitin e ardhshëm fiskal.

Pavarësisht nga këto vështirësi, Universiteti këtë vit ka bërë hapa të rëndësishëm drejt ndërtimit të marrëdhënieve të forta dhe të qëndrueshme me biznese të shumta, nëpërmjet programeve dhe ofertave të shumta. Gjithashtu ai ka qenë në gjendje të përqendrohet dhe t'i bashkojë proceset për ndërtimin e marrëdhënieve të biznesit, kryesisht përmes punës së BRC. Universiteti synon t'i vazhdojë këto qasje në vitin e ardhshëm.

8. Financimi

Në vitin akademik 2014/15, falë iniciativës së Universitetit nga njëra anë dhe përcaktimit pozitiv të Qeverisë së RM nga ana tjetër, Universiteti arriti të thithë subvencione shtetërore në vlerë prej afër 500,000.00 €. Ky subvencion krahas viteve të kaluara akademike ka shkaktuar ndryshim në strukturën e përgjithshme të të hyrave të institucionit. Përderisa vitin akademik paraprak Universiteti në pjesë të madhe vazhdonte të jetë i vetëfinancuar me afër 90% të të ardhurave të përgjithshme, vitin e kaluar ky trend ndryshoi për një përqindje sinjifikante prej 10%. Duke u bazuar në këto të dhëna, struktura e re e të hyrave të Universitetit është si vijon: vetëfinancim 80%, subvencion nga buxheti i shtetit 10%, deri në 5% të ardhura të tjera (të hyra nga aktivitetet komerciale, interesi nga depozitat dhe investimet në tregun e kapitalit, etj) dhe afërsisht deri në 5% nga projekte dhe donacione.

Sa i përket menaxhimit financiar, kanë vazhduar përpjekjet për të arritur përcaktimet strategjike të Universitetit për rruajtjen dhe rritjen e qëndrueshmërisë financiare përmes konsolidimit të burimeve të qëndrueshme të financimit dhe eksplorimit të formave të tjera të financimit dhe diversifikimit të burimeve financiare. Kjo më së miri vërehet nga vendimi i vitit paraprak për të investuar mjetet e lira në depozitat afatshkurtra që njëherësh ka mbuluar edhe koston e rënies së interesit të depozitave në nivel republikan. Nga ana tjetër investimet në tregjet e huaja të kapitalit sollën të hyra shtesë, gjë që tregon funksionalitetin e vendimeve për rritje të qëndrueshmërisë financiare.

Projeksionet e të ardhurave dhe shpenzimeve të Universitetit planifikohen sipas Kornizës afatmesme buxhetore në përputhje me Statutin dhe politikat qeverisëse të Universitetit sipas modelit RAM (Resource Allocation Model). Kjo kornizë afatmesme buxhetore 3-vjeçare e

shpenzimeve siguron konsistencë të niveleve të shpenzimeve të Universitetit brenda kufizimeve të burimeve të përgjithshme, në mënyrë që të sigurohet stabiliteti financiar dhe të maksimizohet efikasiteti i shpenzimeve të përgjithshme. Krahas viteve të kaluara akademike, në vitin akademik 2014/15 më tepër erdhi në shprehje buxheti i bazuar në performancë PBB (Performance Based Budgeting). Ky model jo vetëm që optimizoi kostot, por solli edhe përfitime shtesë.

Në drejtim të rritjes së efektivitetit, efikasitetit dhe transparencës si dhe pasqyrimin real të të ardhurave dhe të hyrave, Universiteti ka vazhduar edhe këtë vit implementimin e plotë të platformës elektronike Enterprise Resource Planning (ERP). Implementimi i kësaj platforme elektronike është mbështetur edhe me inkorporimin e dispozitave ligjore, përpilimin e Planit të ri kontabël dhe përditësimin e vazhdueshëm të procedurave dhe standardeve për shërbimet e financave.

9. Mjedisi dhe shërbimet në kampus

9.1. Përkrahja studentore

Përkrahja e studentëve kryesisht është realizuar nëpërmjet Shërbimeve studentore dhe Zyrës për ndihmë financiare. Studentët për vitin akademik 2014/2015 janë përkrahur financiarisht nëpërmjet programit të bursave të universitetit, grantet e donatorëve të bursave, programi “*Punë dhe studime*”, si dhe programi financiar-zbritje për studentin e dytë dhe të tretë të familjes, në gjithsej rreth **24%** të studentëve të rregullt në studimet deridiplomike financiarisht janë përkrahur në një farë mase.

Programi i bursave përbëhet nga dy grupe: bursat meritore të universitetit në bazë të rezultateve të treguara nga vlerësimi paraprak i diturive dhe bursat në bazë të nevojës financiare, në bashkëpunim me Fondacionin për shoqëri të hapur. Në nivel të Universitetit 287 bursa janë dhënë, d.m.th 156 bursa meritore dhe 104 në bazë të nevojës financiare, që do të thotë se rreth 27 bursa nga komuniteti i biznesit, që do thotë se 14,5% e numrit të përgjithshëm të studentëve të rregullt janë përkrahur me bursa që mbulojnë pjesërisht apo gjithë tarifën e shkollimit në programin e studimit përkatës.

Nga pikëpamja financiare, rreth 4,5 % e studentëve të rregullt janë përkrahur nëpërmjet programit “*Punë dhe studime*”. Përmes këtij programi, studentët u angazhuan në shërbimet e ndryshme të universitetit duke përfituar nga përvoja relevante nga edhe realizojnë mjete financiare për të mbuluar një pjesë të tarifës së shkollimit të tyre. Në këtë vit akademik, 88 studentë ishin të angazhuar në këtë program.

Gjithashtu, në mbështetje të familjeve që kanë më shumë se një student që studion në UEJL është bërë zbritje e pagesës së shkollimit për studentin e dytë ose të tretë nga e njëjta familje. Nëpërmjet këtij programi të Universitetit janë mbështetur 104 studentë, çka përfaqëson 5% të numrit të përgjithshëm të studentëve të rregullt .

Vëmendje e veçantë i është dhënë zhvillimit të qasjes efektive për studentët me nevoja të veçanta dhe mundësitë për bursa për këtë grup të studentëve.

UEJL në bashkëpunim me komunitetin e biznesit ka dhënë 27 bursa që mbulojnë 100% të pagesave të shkollimit në programet e integruara të studimeve. Kjo është dëshmuar si një shtesë e vlefshme për instrumentet ekzistuese për mbështetjen e studentëve dhe kjo do të ndihmojë për të ruajtur lidhjet e forta me kompanitë që duan të mbështetin studentët e UEJL-së me bursa.

9.2. Ngrehinat dhe kapacitetet teknike

Përveç mirëmbajtjes së kapaciteteve me një kujdes të posaçëm, ky vit akademik ka dëshmuar më shumë ndryshime dhe përmirësime në domenin e mirëmbajtjes dhe menaxhimit të kapaciteteve teknike të Universitetit.

Në fillim të vitit është bërë inventarizimi i pajisjeve teknike gjë që ka ndihmuar në menaxhimin më të mirë me ato, posaçërisht në rritjen e efijencës. Zbatimi i standardeve të shërbimit dhe kontrolli dinamik i këtij procesi ka përmirësuar dukshëm mirëmbajtjen e kapaciteteve teknike në disa segmente. Si mirëmbajtja e planifikuar ashtu edhe ajo incidentale është përmirësuar, përmirësim i cili ka shtuar efikasitetin në performancën e shërbimit. Mirëmbajtja bëhet gjithnjë e më tepër preventive, gjegjësisht zëvendësohen dhe riparohen objektet dhe pajisjet me kohë duke pasur parasysh gjithnjë komponentin e efikasitetit. Si rrjedhojë e kësaj departamenti i mirëmbajtjes ia del me më pak fuqi punëtore t'i arrijë qëllimet në aktivitetet e planifikuara. Dëshmi tjetër për këtë përmirësim janë edhe rezultatet e anketimeve të rregullta të studentëve dhe përdoruesve tjerë në Universitet dhe jashtë tij.

Përmirësim tjetër i dukshëm sistemor në vitin akademik 2014/15 është aplikimi i biomases për ngrohje, gjë e cila ka dhënë efekt të madh ekonomik, por edhe ka ndihmuar në ruajtjen e ambientit. Harxhimet për ngrohje janë zvogëluar për 50 %, kurse zvogëlimi i emetimit të gazrave që ndotin ambientin është zvogëluar për gati 100%. Në aspektin e ruajtjes së ambientit është dhënë edhe një kontribut tjetër ku në bashkëpunim me kompaninë PAKO MAK janë siguruar kontejnerë shtesë të cilët ndihmojnë në selektimin e letrave dhe plastikës. Me këtë praktikë do të vazhdohet edhe më tutje për një selektim edhe më të madh, në më shumë objekte dhe më shumë lloje të mbeturinave. Kontribut tjetër në drejtim të ruajtjes së ambientit dhe kursimeve të mëtutjeshme është edhe zëvendësimi i dritave ekzistuese me drita LED. Pas analizave të kostos të bëra nga ekspertët e Universitetit u vendos që ky zëvendësim të bëhet në mënyrë incidentale (poçet konvencionale me gaz neoni që digjen zëvendësohen me poçe të teknologjisë LED). Këtë vit ka filluar edhe automatizimi i ndriçimit në kampus. Në fazën e parë është automatizuar ndriçimi i fushave sportive me komandim me procesor digjital që mundëson ndezjen dhe fikjen e tyre nëpërmjet intranetit. Kjo praktikë do të vazhdojë të aplikohet edhe për vende dhe raste të tjera.

Përveç përmirësimeve të përmendura më lart, këtë vit, departamenti i mirëmbajtjes është ristrukturuar organizativisht për të rritur kapacitetet e menaxhimit të departamentit si dhe kapacitetet e ekspertizës për mirëmbajtje. Struktura e re ka mundësuar në mënyrë më të saktë caktimin e përgjegjësive dhe autorizimeve për të gjithë të punësuarit posaçërisht për udhëheqësit e njësive.

9.3. Qendra e UEJL-së në Shkup

Periodha e mbuluar nga ky raport ishte viti i tetë që Universiteti i EJL është i pranishëm në Shkup si dhe në viti i tretë në mjedisin e ri. Që nga tetori 2013 kampusi i UEJL-së në Shkup është vendosur në një ndërtesë të rinovuar dhe moderne me një sipërfaqe prej 2.400 m², në qendër të kryeqytetit.

Lokacioni doli se ishte një zgjedhje e mirë për praninë UEJL në Shkup. Kampusi ishte shumë i frekuentuar gjatë vitit 2014/15 - me ligjërata për programet universitare të ofruara në Shkup, në të tri ciklet e studimit, por edhe si vend i shumë ngjarjeve, promovime që janë organizuar nga organizatat dhe institucionet partnere të universitetit tonë ose në disa raste në bazë të biznesit.

Dy përfaqësues të rinj nga Kampusi i UEJL-së në Tetovë kanë qenë prezentë në Shkup gjatë këtij viti, përveç stafit administrativ ekzistues: përfaqësuesi i Qendrës së karrierës (një ditë në javë duke u vendosur në hapësirat e ekzistuese të stafit administrativ) dhe Ombudspersoni studentor (në disa raste ose sipas ndonjë orari të caktuar – në hapësirat e Parlamentit studentor). Nga viti 2014/15 Qendra në Shkup është nikoqire e projektit të USAID në përkrahje të personave me pengesa në të pamurit.

Në këtë periudhë nuk kishte ndryshime në pozitat administrative dhe kampusi vazhdoi të funksionojë sipas skemës ekzistuese organizative. Gjatë verës një pozitë administratori ishte vakante për arsye se i punësuar i lëshoi institucionin, por kampusi ishte plotësisht funksional gjatë gjithë verës dhe më pas kjo pozitë u plotësua me të punësuar të ri.

Plani i ri i rishikuar për mbrojtje u miratua përfundimisht nga autoritetet e komunës Qendër dhe u ndërmorën veprime korrespondente për implementimin e tij dhe plotësimin e dokumentacionit dhe vendosjen e shenjave.

Të gjitha pajisjet e instaluar dhe lehtësirat funksionuan në mënyrë të duhur me mirëmbajtjen dhe shërbimet e rregullta. Pajisjet për videokonferencat janë përdorur për të mbështetur komunikimin më të lehtë gjatë takimeve ndërmjet kampuseve.

Shumë ngjarje promovuese u organizuan për të prezantuar dhe afirmuar ofertën akademike të Universitetit në këtë qendër. Gjatë periudhës së aplikimit ne kemi përpunuar me sukses një numër në gjithsej prej 376 regjistrimeve të studentëve të rinj në të tri ciklet e studimeve, që krahasuar me vitin e kaluar shkollor, kur kishim 271 studentë është një rritje prej 105 studentësh apo më shumë se 30%.

Investimi dhe realizimi i hapjes së qendrës së re së UEJL-së në Shkup ka konfirmuar pritjet e menaxhmentit të Universitetit për zgjerimin e operacioneve në Shkup si nga pikëpamja akademike ashtu edhe nga ngjarjet e bazuara perspektivë. Qendra po bëhet një vend i njohur edhe për ngjarjet që sjellin së bashku akademinë dhe biznesin dhe aktorë të tjerë relevantë në shoqëri. Administrata e riorganizuar përgjigjet ndaj nevojave të reja dhe ofron shërbime më të mira për studentët dhe stafin. Rezultate kthyese të vlefshme për arkivat e regjistrimit të studentëve, planifikimin dhe çështje të ngjashme organizative do të raportohen tek menaxhmenti i universitetit në fushën e përmirësimit të operacionit të përgjithshëm universitar. Kështu, Qendra e UEJL-së në Shkup vazhdon të kontribuojë me kapacitetet

infrastrukturore universitare për ofertën akademike dhe zhvillimin, si dhe përfaqëson një njësi të rëndësishme të operacioneve të përgjithshme të UEJL, si një tërësi.

9.4. Burimet njerëzore

Ndryshimet e shpeshta të ligjeve e sidomos të Ligjit për arsimin të lartë dhe Ligjit për marrëdhënie pune kohëve të fundit, e sidomos gjatë vitit akademik 2014/2015 kanë imponuar një aktivitet edhe më të shprehur në fushën e burimeve njerëzore si në domenin e përshtatjes së rregulloreve dhe procedurave ekzistuese me ndryshimet ligjore më të reja, ashtu edhe krijimin e procedurave të reja. Prioritet konstant, edhe këtë vit, ka qenë realizimi i strategjisë lidhur me zhvillimin e burimeve njerëzore, rekrutimin e kuadrit të ri akademik, duke zbatuar parimin e mundësive të barabarta në përgjithësi dhe selektimin dhe punësimin e kuadrit më meritor në veçanti, trajnimin dhe zhvillimin e stafit dhe aplikimin e legjislacionit, rregulloreve dhe procedurave përkatëse

Universiteti edhe këtë vit me sukses ka vazhduar me udhëheqjen dhe procedimin e promovimit të stafit akademik në tituj mësues-shkencorë dhe mësues-profesionalë konform obligimeve ligjore, duke e pasur prioritet nevojën e universitetit në përputhje me nevojat e fakulteteve për kuadro akademike të profileve të caktuara sipas planprogrameve ekzistuese e, sidomos, të atyre që akreditohen për herë të parë

Avancimet e realizuara gjatë vitit akademik 2014/2015 janë: katër profesorë ordinarë, dymbëdhjetë profesorë inordinarë, tre docentë, një docent i titulluar, një lektor i lartë, një lektor dhe një asistent doktorant. Për ta standardizuar procesin e zgjedhjes në titull mësues-shkencor është përgatitur Procedura për zgjedhje në titull.

Në vazhdim të dhënave lidhur me titujt shkencorë të stafit akademik për tre vitet e fundit, ku vërehet qartë rritja permanente e titujve shkencorë doktorë shkencash në përputhje me obligimin ligjor që stafi akademik në marrëdhënie të rregullt pune konform ndryshimeve të Ligjit Për Arsim Siperorë deri me 15. 09. 2015 të kenë tituj mësues-shkencor.

Në vazhdim tabela me të dhënat për titujt shkencorë për stafin akademik për tre vitet e fundit:

Titulli shkencor	2012 / 2013	2013 / 2014	2014 / 2015
PhD	82	77	78
MA	50	40	32
BA	1	1	0

TABELA 5. TITUJT SHKENCORË PËR STAFIN AKADEMIK PËR TRE VITET E FUNDIT

Gjatë vitit akademik 2014/2015 kujdes i veçantë i është kushtuar, gjithashtu, edhe bashkëpunimit të Universitetit me organet kompetente të ministrive të ndryshme, si inspeksionet, në funksion të përmirësimit të dokumentacionit që ka të bëjë me burimet njerëzore. Si rezultat i këtij bashkëpunimi janë bërë disa përmirësime të dukshme në rrjedhën e proceseve dhe dokumentacionit në lidhje me menaxhimin e performancës.

Janë analizuar dhe janë monitoruar edhe rregullshmëria dhe produktiviteti i punës së administratës së universitetit me qëllim të rritjes së nivelit të efektivitetit dhe efikasitetit si dhe kryerja me sukses dhe në kohë e punëve, në mbështetje të stafit akademik dhe të studentëve.

Për të siguruar nivelin e lartë të shërbimit rëndësi e veçantë i është kushtuar procesit të rekrutimit të stafit administrativ me kuadro përkatëse si nga brenda universitetit ashtu edhe nga jashtë, në rastet kur është konstatuar se ato kuadro nuk mund të sigurohen me konkurse të brendshme.

Në vazhdim të dhënave – kualifikimi për tre vitet e fundit për stafin administrativ në marrëdhënie të rregullt pune:

Titulli shkencor	2012 / 2013	2013 / 2014	2014 / 2015
PhD	2	2	3
MA	14	16	14
BA	67	62	66

TABELA 6. KUALIFIKIMI PËR TRE VITET E FUNDIT PËR STAFIN ADMINISTRATIV NË MARRËDHËNIE TË RREGULLT PUNE

Edhe këtë vit ka vazhduar me sukses kontrollimi dhe raportimi lidhur me rregullshmërinë në punë, hyrje daljet zyrtare dhe private brenda orarit të punës për stafin administrativ, po ashtu i është kushtuar rëndësi e veçantë procedimit të pushimeve mjekësore dhe atyre të lindjes.

Është konstatuar në përgjithësi respektim dhe shfrytëzim efektiv i kohës së punës. Në bashkëpunim intensiv me shërbimin e TI dhe në përputhje me normat ligjore për ruajtjen e të dhënave personale janë kompletuar të dhënat e kërkuara për tërë stafin administrative dhe akademik. Konform Planit të veprimit të Zyrës së burimeve njerëzore për vitin 2015/16, në bashkëpunim me shërbimin e TI pritet të vihet në zbatim softueri i ri për menaxhimin e burimeve njerëzore.

9.5. Sistemet e informacionit

Viti akademik 2014/2015 ishte një detyrë mjaft kërkuese dhe sfiduese për Universitetin në lëmin e teknologjisë informacionit. Qëllimi ishte që Universiteti të ndërtojë një sistem elektronik për planifikimin dhe menaxhimin e resurseve akademike me anë të të cilit do të mundësohet optimizimi i shfrytëzimit të resurseve akademike. Detyra në vete ngërthen skicimin e procesit dhe të kërkesave të aktorëve relevantë në procesin akademik, zhvillimin e moduleve bazuar në pamjen ('user view'). U zhvilluan modulet për planifikim akademik, për zyrën e dekanit, për mësimdhënësin, për menaxhmentin e lartë, për Zyrën e burimeve njerëzore, për studentin dhe të tjera. Pjesa më e madhe e projektit është zhvilluar dhe realizuar me sukses dhe ai është vendosur në përdorim në muajin gusht 2015. Kjo ka mundësuar që viti i ri akademik të fillojë duke i bërë planifikimet e nevojshme për angazhimet akademike si dhe orarin e semestrit dimëror në sistemin e ri. Njëherësh, kjo periudhë u shfrytëzua që të adresohen problemet të cilat do të paraqiten gjatë përdorimit të sistemit nga të gjithë aktorët në proces. Realizimi i plotë i detyrës për zhvillimin e sistemit elektronik për planifikim akademik është një proces kompleks dhe ai do të vazhdojë edhe gjatë vitit akademik 2015/2016.

Gjithashtu ka vazhduar zhvillimi i më tejme dhe pasurimi me opsione të reja të sistemeve ekzistuese. Këtu vlen të theksohet automatizimi i plotë i procesit të diplomimit që nënkupton se tani sistemi e mbulon procesin tërësisht duke filluar prej inicimit të kërkesës nga ana e studentit dhe deri te prodhimi i diplomës finale. Kjo është e realizuar për të gjitha ciklet e studimit. Në pjesën e UMS-së është elektronikuar procesi për regjistrim të semestrit dhe është

ridizajnuar moduli për transfere dhe reregjistrime duke i shtuar disa funksionalitete për regjistrim të provimeve dhe ngarkesave financiare.

Në pjesën e sistemit për ERP është realizuar ndërlidhja e modulit për burime njerëzore (HR) me sistemin e ri elektronik për planifikim akademik. Kjo mundëson që të dhënat në sistem për të punësuarit në akademi të jenë të përditësuara në kohë reale. Për pjesën që ka të bëjë me stokun (magazinën) dhe që është e lidhur si me procesin e prokurimit po ashtu edhe me ndjekjen e shpenzimeve materiale, është funksionalizuar moduli për stokun dhe ai është në fazën përfundimtare të jetësimit.

Tërë këto zhvillime, ndryshime dhe risi të rëndësishme në fushën e teknologjisë së informacionit dëshmojnë se Universiteti në vazhdimësi demonstroi dedikim në ndjekjen dhe implementimin e praktikave më të mira në botë në lëmin e teknologjisë së informacionit.

9.6. Shërbimet e bibliotekës

Në vitin akademik 2014-2015 Biblioteka me sukses i kreu punët e saj të rregullta për nevojat e studentëve dhe stafit akademik me shërbimet e nevojshme, pra me libra dhe materiale elektronike, nëpërmjet fondit ekzistues të librave në Bibliotekë dhe databazave të disponueshme EBSCO dhe EKON-BIZ. Gjithashtu me saktësi, efikasitet dhe në kohë të duhur janë përpunuar, janë klasifikuar dhe janë katalogizuar të gjitha librat e reja të blera, posaçërisht fondi I librave të Qeverisë, të donuara nga ASHAM.

Gjatë gjithë kohës është organizuar fushatë permanente për përdorimin e databazave si të studentët e rinj ashtu edhe tek tjerët. Gjithë këto veprime janë mundësuar falë stafit profesionist, efikas dhe të devotshëm të Bibliotekës. Gjithashtu me lehtësi janë bërë edhe transferet e materialeve të duhura për Bibliotekën në Shkup dhe anasjelltas. Edhe këtë vit ka vazhduar bashkëpunimi me Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare Shkup, veçanërisht huazimit të materialeve që ne nuk i posedojmë si dhe me Bibliotekën Universitare të Kosovë.

Gjatë kësaj kohe Biblioteka i ka kushtuar një rëndësi të posaçme edhe promovimeve të librave nga autorët vendorë me rëndësi shkencore dhe kulturore. Në suksesin e punës kanë kontribuar edhe studentët e "Work-study"-it të aftësuar nga stafi I bibliotekës.

Pengesa e vetme për rritjen e cilësisë së punës në këtë periudhë ka qenë çështja e prokurimit të rënduar për librat nga Shqipëria dhe Turqia, kjo për shkak se kjo literaturë nuk gjendet në 'Amazon', por duhet të prokurohet direkt. Kjo është shumë e rëndësishme dhe veçanërisht për faktin se tani studentët nga Turqia janë në vitin e dytë, kurse ne nuk mund të sigurojmë literaturë për ta.

9.7. Parlamenti i studentëve

Parlamenti studentor përbëhet prej anëtarëve të zgjedhur nga të dy kampuset në Tetovë dhe Shkup dhe nga studentët në studimet deridiplomike dhe pasdiplomike. Parlamenti shërben si përfaqësimi kryesor i studentëve në organizimin e Universitetit. Përfaqësuesit parlamentarë gjithashtu shërbejnë në fushat e tjera të Universitetit, si në këshillat mësimore-shkencore të fakulteteve, në Senatin e Universitetit, etj.

Gjatë periudhës së mbuluar nga ky raport, Parlamenti studentor ishte aktiv në promovimin e ngjarjeve ku studentët ishin në qendër, të tilla si debate, ahengje, lojëra dhe gara sportive, si dhe nisma të tjera të ngjashme. Parlamenti gjithashtu organizoi udhëtimin mjaft popullor "Eurotrip" në kryeqytetet kryesore evropiane.

Përveç punës së tyre si përfaqësues formalë të studentëve, Parlamenti studentor ka marrë pjesë, gjithashtu, në disa veprime humanitare (të tilla si përpjekje për të ndihmuar fëmijët me aftësi të kufizuara, njerëzit në nevojë dhe familjet nga Kumanova) dhe ka marrë pjesë në protesta paqësore kundër testimit ekstern dhe ndotjes së ajrit.

9.8. Sporti dhe rekreacioni

Departamenti i sportit është njësi e vogël organizative në Universitet e përbërë nga një staf me orar të plotë pune dhe me një të angazhuar part-time. Megjithatë këtij departamenti këtë vit akademik i ka shkuar për dore të arrijë rezultate dhe përmirësime të dukshme në masivizimin dhe shtirjen e gjerë të sportit në Universitet. Aktivitetet filluan me bërjen e anketave në mesin e studentëve me qëllim të mbledhjes së informatave për preferencat e studentëve lidhur me sportin. Ky grumbullim i informatave i ndihmoi Universitetit të fokusojë aktivitetet në sporte të caktuara, natyrisht duke marrë parasysh edhe kushtet me të cilat disponon Universiteti. Përmes inkuadrimin në Federatën e sportit universitar, Universiteti ka bërë përpjekje për masivizimin dhe popullarizimin e sportit ndër studentë dhe universitete

Përmirësim i parë që u arrit të bëhet ishte ngjallja dhe masivizimi i sportit në qendrën universitare në Shkup. Kjo u arrit me sigurimin e termineve për aktivitete të rregullta sportive në qendrën sportive „Boris Trajkovski” dhe për not në pishinën olimpike në Shkup. Përveç kësaj, në objektin e Universitetit, u organizuan aktivitete sportive në ping-pong dhe shah. Masivizimit dhe diversifikimit të aktiviteteve sportive i kontribuoi edhe ruta me biçikleta nëpër qytetin e Shkupit. Gjitha këto aktivitete kontribuan në kyçjen e një numri të konsiderueshëm të studentëve në aktivitetet sportive në Shkup.

Edhe këtë vit, përveç turneve që mbahen rregullisht në kuadër të kampusit, Universiteti organizoi aktivitete sportive të ndryshme sportive (fitness, vallëzim, futboll, tenis, basketboll, ping-pong, shah, atletikë-kros). Me njësinë e alpinistëve dhe të çiklistëve u organizuan disa ruta ku morën pjesë më shumë se 100 studentë nga të dy kampuset. Organizim tjetër që vlen të theksohet është edhe turneu tradicional në futboll të vogël për shkollat e mesme të rajonit i cili është shumë interesant edhe për studentët edhe për nxënësit.

Përveç aktiviteteve të cilat janë mbajtur në Universitet, studentët, këtë vit kanë përfituar edhe nga pjesëmarrja në garat ndëruniversitare dhe ndërkombëtare. Gara ndëruniversitare janë organizuar kryesisht në futboll ku studentët kanë arritur rezultate të lakmueshme. Sa i përket garave ndërkombëtare, Universiteti ka marrë pjesë aktive si në organizim ashtu edhe në garat në skijim për studentët, të organizuara në Shqipëri (Korçë).

10. Konkluzionet

Universiteti i Evropës Juglindore vazhdon të ndjekë sfidën e vendosur nga themeluesit e tij, ofrimin e arsimit ndërkombëtar konkurrues në tri gjuhët zyrtare të Universitetit dhe pa preferenca apo paragjykim ndaj ndonjë grupi ose individi.

Ashtu si edhe të gjitha institucionet e arsimit të lartë, UEJL ballafaqohet me një situatë të vështirë ekonomike që e ka përfshirë mbarë botën, por edhe hapësirën e këtushme. Për më tepër, universitetet e shumta private, ose shtetërore të decentralizuara konkurrojnë për studentë. Këto realitete e bëjnë rekrutimin e studentëve edhe më të vështirë, por e bëjnë të vështirë edhe ofrimin dhe shpërndarjen e burimeve. Që UEJL është në gjendje të mbajë cilësi të lartë akademike në të dy kampuset është dëshmi e angazhimit stafit për misionin e Universitetit.

Ky raport përmban rekomandime brenda seksioneve të veçanta. Në vijim janë rekomandimet më të përgjithshme të cilat zakonisht janë miratuar nga stafi akademik dhe administrativ, si dhe nga studentët. Universiteti duhet të angazhohet:

- ta rrisë regjistrimin e studentëve në ciklin e parë, veçanërisht për kampusin e Tetovës;
- ta përmirësojë bashkëpunimin me bizneset dhe ndërmarrësit lokalë;
- ta fitojë dhe ta ruajë përkrahjen financiare qeveritare gjë që mundëson që bursat tona të jenë më bujare;
- t'i vazhdojë iniciativat tona rajonale për kujdesin ndaj mjedisit;
- ta përmirësojë mbështetjen e studentëve dhe përgjegjshmërinë e stafit ndaj shqetësimeve dhe ankesave të studentëve;
- t'i forcojë resurset hulumtuese (qasje në bazën e të dhënave) për studentët në studimet pasdiplomike dhe stafin;
- ta rrisë shkallën e diplomimit në kohë.

Universiteti i Evropës Juglindore përballlet me disa vështirësi që janë të llojit të vet; shumica e sfidave me të cilat përballemi janë të ngjashme me ato të hasura nga ofruesit e arsimit të lartë në mbarë botën. Pasi, që ende përballemi me një mjedis sfidues, ne vazhdojmë të besojmë se vizioni themelues i Universitetit është qëllimi ynë, të ofrojmë mësimdhënie akademike me cilësi të lartë në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe ta ofrojmë këtë në mënyrë të barabartë për të gjithë studentët, pavarësisht nga përkatësia etnike, gjuhësore, fetare, gjinisë, apo përkatësisë politike.

Anëtarët e komisionit të vetëvlerësimit

- ❖ Provosti
- ❖ Sekretari i përgjithshëm
- ❖ Prorektori për ndërmarrësi dhe planifikim
- ❖ Këshilltarja ekzekutive për cilësi
- ❖ Përgjegjësi i Qendrës së UEJL-së Shkup
- ❖ Drejtori i Shërbimeve studentore
- ❖ Përgjegjësi i Qendrës së karrierës
- ❖ Përfaqësues të të gjithë pesë fakulteteve
- ❖ Drejtori i Qendrës së gjuhëve
- ❖ Drejtori i Qendrës për eMësim
- ❖ Përfaqësues të Parlamentit studentor
- ❖ Asistenti për sigurimin e cilësisë, përkrahje teknike

(Komiteti dëshiron gjithashtu t'i mirënjohë kontributet e bëra nga Fikret Shabani në përmbajtjen e këtij raporti dhe punën e Daniela Ilievskës dhe Rexhep Xheladinit për përkthimin).